

Standardeve të Cilësisë për Barnahus

Përmbledhje

Seria e projekteve PROMISE

(Premtimi)

www.barnahus.eu

Botues: Sekretariati i Këshillit të Shteteve të Detit Baltik dhe Child Circle

Autore: Olivia Lind Haldorsson, *Child Circle*

Parathënia dhe kontributi kryesor:

Bragi Guðbrandsson, *Agjensia Qeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, Islandë*

Grupi i ekspertëve:

Gordana Buljan Flander, *Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, Zagreb*

Åsa Landberg, *Psikologe dhe Psikoterapeute*

Resmiye Oral, *Programi për Mbrojtjen e Fëmijëve, Universiteti i Iowa-s*

Carl Göran Svedin, *Barnafrid – Nationellt kunskapscentrum, Universiteti i Linköping*

Redaktore dhe konsulente ligjore:

Rebecca O'Donnell, *Child Circle*

Redaktimi dhe praktikat e mira:

Jannet van Bavel, *Qendra për*

Traumat e Fëmijëve dhe të Rinjve, Harlem

Tea Brezinscak, *Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, Zagreb*

Britta Bäumer, *Njësia për Traumat Psikiatrike të Fëmijët dhe të Rinjtë, Barnahus Stokholm*

Ylva Edling, *Njësia për Traumat Psikiatrike të Fëmijët dhe të Rinjtë, Barnahus Stokholm*

Ólöf Ásta Farestveit, *Barnahus Reykjavik*

Anna Frank-Viron, *Children's House, Departamenti për Mbrojtjen e Fëmijëve, Komiteti për Sigurimet Shoqërore*

Turig Heiberg, *Sekretariati i Këshillit të Shteteve të Detit Baltik*
Peter van der Linden, *Instituti Verwey-Jonker*

Anna Nelsson, *Barnahus Linköping*
Anna M Petersson, *Barnahus Linköping*

Ana Marija Spanic, *Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, Zagreb*

Andrea Wagner Thomsen *Qendra për Fëmijët, të Rinjtë dhe Familjet, Këshilli Kombëtar për Shërbimet Shoqërore*

Kontributet pilote:

Michael van Aswegen, *TUSLA Irlandë*

Dainora Bernackiene, *Divizioni për Fëmijët, Departamenti për Familjen dhe Komunitetet, Ministria e Sigurimeve Shoqërore dhe Punës, Lituani*

Andreea Bijii, *Save the Children Rumani*

Laura Celmale *Shoqata Qendra Dardedze, Letoni*

Adina Mihaela Codres, *Ministria e Punës, Familjes, Mbrojtjes shoqërore dhe të Moshuarve, Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Birësimin, Rumani*

Fondacioni ESZTER, *Hungari*

Maria Keller-Hamela, *Fondacioni "Empowering Children", Poloni*

Vasiliki Kourri, *Qendra e Politikave CRC "Hope for Children", Qipro*

Ann Lind-Liiberg, *Departamenti për Fëmijët dhe Familjet, Ministria e Çështjeve Sociale*

Viola Läänemand, *Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Këshilli Kombëtar për Sigurimet Shoqërore, Estoni*

Andrea Moehringer, *ChildHood Gjermani*

Lauris Neikens, *Departamenti i Politikave për Fëmijët dhe Familjet, Ministria e Mbrojtjes Shoqërore, Letoni*

Beata Wojtkowska, *Fondacioni "Empowering Children"*

Shkëmbimet ndër shtetet pilote:

Bullgari: *Instituti për Veprimtaritë dhe Praktikrat Shoqërore (SAPI)*

Qipro: *Qendra e Politikave CRC*

"Hope for Children" dhe *Ministria e Shërbimeve Shoqërore Angli: NHS*

Angli

Estoni: *Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Këshilli Kombëtar për Sigurimet Shoqërore, Ministria e*

Çështjeve Sociale

Gjermani: *ChildHood Gjermani*

Hungari: *Barnahus Szombatehly, Fondacioni ESZTER dhe Hungarian*

Church Aid

Irlandë: Forcat e Policisë Irlandeze dhe TUSLA

Letoni: Shoqata Qendra Dardedze dhe Departamenti për Politikën e Fëmijëve dhe Familjes, Ministria e Mbrojtjes Shoqërore

Lituani: Divizioni për Fëmijët, Departamenti për Familjen dhe Komunitetet, Ministria e Sigurisë Shoqërore dhe Punës dhe Shtëpia sociale shoqërore "Užuovėja"

Luksemburg: Ministria e Arsimit, Fëmijëve dhe Rinisë

Maltë: FSWS-Appogg, Shërbimet për Mbrojtjen e Fëmijëve

Poloni: Fondacioni "Empowering Children"

Rumani: Ministria e Punës,

Familjes, Mbrojtjes shoqërore dhe të Moshuarve, Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Birësimin dhe Save the Children Rumani
Skoci: "Children First" Skoci dhe Shërbimi i gjykatave Skoci

Redaktore:

Rebecca O'Donnell
Daja Wenke

Paraqitja grafike:

Christine Ashton
Shawna von Blixen

Zbatimi i "Standardeve të Cilësisë për Barnahus" nëpër Evropë

PROMISE po ndihmon Evropën në zbatimin e modelit Barnahus si praktikë standard për t'u siguruar fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës qasje të shpejtë te drejtësia dhe te shërbimet e kujdesit. E kemi marrë përsipër këtë punë për të përmbushur vizionin e PROMISE: një Evropë ku përmbushen të drejtat e fëmijëve për t'u mbrojtur nga dhuna, për t'u mbështetur dhe për t'u dëgjuar.

Një Barnahus siguron bashkëpunimin shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional midis organeve të ndryshme për të siguruar që fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës të marrin përgjigje profesionale, efektive dhe të përshtatur për fëmijët, në një ambient të sigurt i cili parandalon (ri)traumatizimin. Me mbështetjen zyrtare të autoriteteve kombëtare, PROMISE siguron mundësi për të kthyer zotimet kombëtare në veprime konkrete dhe për t'u angazhuar në këtë proces në nivel ndërkombëtar. Përveç kësaj, rrjetëzimi i rregullt dhe komunikimet strategjike aktivizojnë vazhdimisht rrjetin në rritje të profesionistëve dhe të palëve të interesuara, të cilët janë të përkushtuar të prezantojnë dhe zgjerojnë shërbimet Barnahus në rang kombëtar.

Projekti i parë PROMISE (2015-2017) vendosi standardet evropiane dhe angazhoi një rrjet të gjerë profesionistësh. Projekti i dytë PROMISE (2017-2019) promovoi ecurinë në shkallë kombëtare drejt përmbushjes së standardeve dhe zyrtarizoi Rrjetin "PROMISE Barnahus". Puna në të ardhmen do të zgjerojë këto aktivitete për të përfshirë trajnime në universitete, instrumente për menaxhimin e rasteve individuale dhe një sistem akreditimi evropian.

PROMISE administrohet nga Njësia e Fëmijëve në Rrezik të Sekretariatit të Këshillit të Shteteve të Detit Baltik, në bashkëpunim të ngushtë me Child Circle.

Njihuni me instrumentet e PROMISE dhe mëso më shumë te faqja

www.barnahus.eu



Ky punim është i licencuar nga Këshilli i Shteteve të Detit Baltik sipas licencës ndërkombëtare "Creative Commons Attribution-NonCommercial-NoDerivatives 4.0 International License".

Keni dëshirë ta përktheni këtë dokument? Lutemi kontaktoni Këshillin e Shteteve të Detit Baltik për të mësuar më tepër në lidhje me formatin, akreditimin dhe të drejtat e autorit.

Botuar për herë të parë në vitin 2017. Ribotuar në vitin 2019.

Përmbajtja

Vizioni i PROMISE	2
Parathënie	5
Hyrje	9
Modeli Barnahus	17
Standardet Barnahus	24
Çelësi për leximin e Profileve Standarde	27
Standardi 1: Parimet kyçe dhe aktivitetet ndërsektorale	30
Standardi 2: bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional në Barnahus	48
Standardi 3: Grup i synuar gjithëpërfshirës	56
Standardi 4: Mjedis i përshtatur për fëmijët	60
Standardi 5: Menaxhimi ndërinstitutional i çështjeve	64
Standardi 6: Intervistat mjekoligjore	74
Standardi 7: Ekzaminimi mjekësor	83
Standardi 8: Shërbimet terapeutike	87
Standardi 9: Ngritja e kapaciteteve	92
Standardi 10: Parandalimi: Shpërndarja e informacionit, ndërgjegjësimi dhe ngritja e aftësive të jashtme	96
Lidhja midis dispozitave, detyrimeve ligjore dhe Standardeve Evropiane për një Barnahus: pamje e përgjithshme	100

Vizioni i PROMISE

Vizioni i projektit PROMISE është një Evropë ku përmbushen të drejtat e fëmijëve për t'u mbrojtur nga dhuna, për t'u mbështetur dhe për t'u dëgjuar. Për këtë qëllim, fëmijët viktimë ose dëshmitarë të dhunës në Evropë mbrohen me ndërhyrje të përshtatura për fëmijët dhe me qasje të shpejtë në drejtësi dhe përkujdesje sipas parimeve kryesore të mëposhtme:

1. Respektim i së drejtës së fëmijës për pjesëmarrje, duke u siguruar që fëmija të dëgjohet dhe të marrë informacionin dhe mbështetjen e duhur për t'i ushtruar këto të drejta;
2. Bashkëpunim shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional gjatë hetimeve, procedurave, diagnostikimeve, vlerësimit të nevojave dhe dhënies së shërbimeve, me qëllim që të shmanget traumatizimi i mëtejshëm dhe të arrihen rezultate në pajtim me interesin më të lartë të fëmijës;
3. Shërbime gjithëpërfshirëse dhe të arritshme që përmbushin nevojat individuale dhe komplekse të fëmijës dhe të familjes ose kujdestarit jo abuzues të tij/saj;
4. Duke garantuar standardet e larta profesionale, trajnimin dhe burimet e përshtatshme për personelin që punon me fëmijët dëshmitarë dhe viktimë të dhunës.

Modeli Barhaus i referohet ndërhyrjeve shumëdisiplinore dhe ndërinsticionale të organizuara në një kuadër të përshtatur me fëmijët, i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

1. Intervista mjekoligjore zhvillohet sipas një protokollit të mbështetur në prova;
2. Vlefshmëria e dëshmisë së fëmijës, e cila ka vlerën e provës, respekton *procesin e rregullt ligjor*, duke shmangur njëkohësisht edhe nevojën që fëmija të përsërisë dëshminë në seancë gjyqësore, nëse formulohet ndonjë akuzë;
3. Vlerësimi mjekësor kryhet në funksion të hetimeve mjekoligjore dhe për të siguruar mirëqenien dhe rikuperimin fizik të fëmijës;
4. Jepet mbështetje psikologjike, përfshirë këtu shërbimet terapeutike afatshkurtra dhe afatgjata, që trajton traumën e fëmijës dhe të anëtarëve të familjes ose të kujdestarit jo abuzues të fëmijës;
5. Kryhet vlerësimi i nevojës për mbrojtje të fëmijës viktimë dhe i fëmijëve të tjerë të familjes dhe më pas ndiqet për vijimësi.

PROMISE mbështet përfshirjen e institucioneve kombëtare dhe vendore, qofshin këto qeveritare ose jo, për ngritjen e institucioneve të tipit Barnahus dhe të përshtatura me fëmijët. Për një qasje evropiane, progresi në të gjitha vendet nxitet nga shkëmbimi i praktikave të mira dhe i standardeve të larta si më poshtë:

1. Duke parandaluar, hetuar dhe duke iu përgjigjur dhunës ndaj fëmijëve nëpërmjet bashkëpunimit shumëdisiplinor dhe shumëpalësh të profesionistëve dhe organeve në fushën e kujdesit social e shëndetësor dhe në fushën penale para, gjatë dhe pas procedimeve;

2. Duke identifikuar praktikat e mira në a) *bashkërendimin*, punën e përbashkët dhe përshtatjen reciproke mes institucioneve; b) *bashkëpunimin* midis institucioneve dhe c) *bashkëpunimin* në kuadrin e shërbimeve të përbashkëta midis institucioneve në frymën e politikëbërjes së përbashkët;
3. Duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtën e fëmijës për të pasur një fëmijëri pa dhunë.

Për të arritur këtë vizion, PROMISE nxit dhe mbështet krijimin e modelit Barnahus, ose të modeleve të ngjashme me të, në të gjitha vendet e Evropës. PROMISE inkurajon rritjen e bashkëpunimit shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional, në mënyrë që fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të dhunës të marrin përgjigje profesionale, të përshtatur për fëmijët dhe të efektshme në një mjedis të sigurt. Rrjeti evropian dhe ai global i profesionistëve gëzojnë mbështetje në përhapjen e vizionit të PROMISE përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit.

Puna e bërë në kuadrin e PROMISE mbështetet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, në Direktivën evropiane "Për të drejtat e viktimave", në Direktivën evropiane "Për abuzimet seksuale ndaj fëmijëve", në Direktivën evropiane antitrafik dhe në Konventën e Këshillit të Evropës, nënshkruar në Lanzarote. Puna e PROMISE mbështetet edhe në rekomandimet dhe udhëzimet e BE-së dhe të Këshillit të Evropës për sistemet e integruara për mbrojtjen e fëmijëve, për drejtësinë e përshtatur me të miturit dhe për shërbimet sociale të përshtatura me të miturit.

Parathënie

European Barnahus Standards (Standardet evropiane për një Barnahus) përfaqësojnë përpjekjen e parë në Evropë për të përcaktuar parimet e ndërhyrjes dhe të shërbimeve të njohura me emrin modeli "Barnahus". Emri Barnahus ("shtëpi për fëmijë") e ka origjinën në Islandë, aty ku u themelua struktura e parë Barnahus në vitin 1998. Që atëherë, u ngritën shumë Barnahus, kryesisht në vendet nordike.

Ratifikimi thuajse universal i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dha kontribut për rritjen e konvergencës së politikave dhe praktikave të mbrojtjes sociale të fëmijëve në Evropë, nxitur nga bashkëpunimi në rritje dhe nga përpjekjet e përbashkëta të shumë palëve ku përfshihen organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, shoqatat profesionale dhe universitetet. Këtu shtojmë edhe ndikimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të cilat i janë referuar KDF-së në një numër gjithmonë e më të madh vendimesh të marra dhjetëvjeçarin e fundit. Si rezultat, dy traditat e ndryshme të shërbimeve sociale për fëmijët në Evropë - "Child Rescue" e shtyrë drejt politikave dhe procedurave, nga njëra anë dhe "Family support" e orientuar më shumë drejt familjes dhe më pak drejt fëmijës, nga ana tjetër - janë zëvendësuar gradualisht nga strategji të mbështetura në qasjet e bazuara te të drejtat që burojnë nga KDF-ja.

Këto zhvillime kanë krijuar kontekstin në të cilin janë ushqyer dhe vazhdojnë të përhapen parimet dhe praktikat e modelit Barnahus.

Barnahus mund të shihet si një përpjekje për "të futur në punë" të drejtën e fëmijëve për të përfutur mbështetje dhe mbrojtje të mjaftueshme dhe për të pasur qasje në drejtësinë e përshtatur për fëmijët. *European Barnahus Standards* mishërojnë këto praktika operacionale dhe, si të tilla, duhet të shihen si udhërrëfyes në rrugëtimin drejt rritjes së të drejtave të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës.

Modeli Barnahus parashikon një qasje shumëdisiplinore dhe ndër-institucionale, duke siguruar bashkëpunimin midis organeve të ndryshme (gjyqësore, sociale, shëndetësore) në një mjedis të përshtatur për fëmijën, i cili ofron shërbime gjithëpërfshirëse për fëmijën dhe familjen nën të njëjtën çati. Ky model mbështetet në hipotezën se komunikimi i fëmijës është çelësi për të zbuluar dhe hetuar abuzimin me fëmijën për qëllime të drejtësisë penale, për qëllime mbrojtjeje dhe terapeutike.

Edhe pse termi "Barnahus" ka një kuptim të qartë, rrugët e krijimit të strukturave Barnahus dhe format e tyre organizative ndryshojnë nga shteti në shtet dhe ndonjëherë dhe brenda vetë shtetit. Ka ndryshime të grupet e synuara, të pranëvënja e roleve dhe përgjegjësi si dhe të kuadri i bashkëpunimit midis partnerëve për zbatimin e funksioneve kryesore. Këtu përfshihet, për shembull, cili profesionist kryen intervistat mjekoligjore, cili protokoll mjekoligjor zbatohet ose mënyra si lëvrohen shërbimet terapeutike dhe mjekësore.

Këto dallime nga pikëpamja operative nënvizojnë elasticitetin e modelit dhe zgjuarsinë me të cilën i është përshtatur sistemeve ligjore, strukturave sociale, traditave kulturore dhe praktikave profesionale në shtete të ndryshme, gjë që shërben si frymëzim dhe

inkurajim për këdo që dëshiron të krijojë një Barnahus. Është me rëndësi të shënohet se Barnahus nuk është asnjëherë model i ngurtë, por një praktikë që evoluon, gati për t'u përshtatur me nevojat komplekse të fëmijëve viktime ose dëshmitarë të dhunës.

Pikërisht kur përcaktohet korniza, brenda së cilës ka hapësirë për elasticitet dhe përshtatje, bëhet e qartë rëndësia e *European Barnahus Standards*. Sigurisht që ka kufij për ndryshimet në zbatimin e modelit sepse duhet ruajtur ndërkohë origjinaliteti i tij. Strukturat Barnahus bazohen te praktikatat e mbështetura në prova, përfshirë këtu protokollet mjekoligjore, ndërhyrjet terapeutike dhe ekzaminimet mjekësore. Kur modeli Barnahus zbatohet në kultura të ndryshme, besnikëria ndaj këtyre parimeve të bazuara në prova është kritike.

Sot, parimet dhe praktikatat e modelit Barnahus pasqyrohen dhe promovohen, heshtur ose haptas, në shumë sisteme ligjore dhe korniza politikash të Këshillit të Evropës (KE) dhe të Bashkimit Evropian (BE), duke përfshirë Konventën e KE-së "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual" (2010)¹, Udhëzimet e KE-së për një drejtësi të përshtatur për fëmijët (2010)², Rekomandimi i KE-së për shërbime sociale të përshtatura për fëmijët (2011)³, Direktiva e BE-së "Për luftën ndaj abuzimit seksual dhe

¹ Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (CETS Nr. 201)

² Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatur për fëmijë (Miratuar nga Komiteti i Ministrave në 17 nëntor 2010 në takimin e 1098-të të Zëvendësministrave)

³ Rekomandimi i Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijëve dhe për shërbimet sociale të përshtatura për fëmijët dhe familjet

shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë" (2011)⁴ dhe Direktiva e BE-së "Për standadat minimale të të drejtave, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit" (2012)⁵.

Shumica e shteteve evropiane kanë marrë angazhim të zbatojnë detyrimet e parashikuara në legjislacionin ndërkombëtar dhe rajonal, tek i cili i ka rrënjët edhe modeli Barnahus. Uroj që zbatimi i *European Barnahus Standards* të tregojë se është një instrument i çmuar për ta çuar deri në fund këtë sipërmarrje.

Bragi Guðbrandsson, mars 2017

⁴ DIREKTIVA 2011/93/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 13 dhjetor 2011, "Për luftën ndaj abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë"

⁵ DIREKTIVA 2012/29/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 25 tetor 2012, e cila përcakton standadat minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA

Hyrje

Kur një fëmijë pëson dhunë, institucione të ndryshme si shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore, shërbimet e shëndetit mendor dhe organet e zbatimit të ligjit kanë detyrën të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës. Çdo organ merr përsipër përgjegjësinë individuale për të siguruar që roli i tij të përmbushet në mënyrë të përshtatur me fëmijën dhe se konsiderata parësore mbetet interesi më i lartë i fëmijës.

Aty ku këto organe nuk punojnë së bashku, fëmija mund t'i nënshtrohet hetimeve dhe vlerësimeve paralele, duke u përplasur sa te një agjenci dhe disiplinë te tjetra. Kërkimet dhe përvojat klinike kanë treguar se intervistat e përsëritura me persona të ndryshëm, në vende të ndryshme dhe nga shërbime të ndryshme, kombinuar me metoda të papërshtatshme intervistash, kanë kontribuar për ri-traumatizimin e të miturit.⁶

⁶ Shih si shembull: Henry, Jim (1997). Following Disclosure, System Intervention Trauma to Child Sexual Abuse Victims. *Journal of Interpersonal Violence* 12: 499; Newgent, Rebecca A., Fender-Scarr, Lisa K. and Bromley, Jamie L. (2002). The Retraumatization of Child Sexual Abuse: The Second Insult. National Institute for Trauma and Loss in Children, Volume 2, Number 2, Fall 2002; Newlin, Chris, Cordisco Steele, Linda, Chamberlin, Andra, Anderson, Jennifer, Kenniston, Julie, Russell, Amy, Stewart, Heather and Vaughan-Eden, Viola (2014). Child Forensic Interviewing: Best Practices. U.S. Department of Justice Office of Justice Programs Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention; Westcott Helen L. and Davies, Graham M (eds) (2002). *Children's Testimony: A Hand-book of Psychological Research and Forensic Practice*. Wiley Series of the Psychology of Crime, Policing and Law, July 2002; Jansson, Helene, Rathje, Pia and Gade Hansen, Søren (2015). The experience of children testifying in court in cases of sexual abuse. *Sexological Clinic at PCK*

Ky është problem serioz pasi komunikimi i fëmijës është thelbësor për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës, për të përcaktuar nevojën për rikuperim fizik dhe mendor dhe për të siguruar një ⁷ hetim penal dhe proces gjyqësor të suksesshëm dhe të përshtatur për të miturit⁸. Përveç kësaj, mospërputhjet e paqëllimita ndërmjet intervistave të kryera në kohë dhe vendndodhje të ndryshme dhe nga njerëz me nivele të ndryshme kompetencash mund të çojnë në diskreditimin e fëmijës si dëshmitar.⁹

Në vitet e fundit, është njohur gjithmonë e më shumë fakti se bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitucional (ShD /NI) është thelbësor për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës për mbrojtje, pjesëmarrje, mbështetje dhe ndihmë. Bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitucional mund të sjellë përfitime të konsiderueshme si për fëmijët ashtu edhe për

Copenhagen, Center for Sexual Abuse, Rigshospitalet Copenhagen and the National Council for Children, Denmark

⁷ Drejtësia e përshtatur për fëmijën "i referohet sistemeve të drejtësisë që garantojnë respektimin e zbatimit efektiv të të gjitha të drejtave të fëmijëve në nivelin më të lartë të arritshëm" (Këshilli i Evropës, Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatur për fëmijën dhe memorandum i tyre shpjegues (2011, fq. 4.)

⁸ Hetimet penale dhe procedurat gjyqësore mund të ndryshojnë nëpër Evropë, madje edhe në mënyrën në të cilën përfshihen fëmijët. Komisioni Evropian ka kryer njëstudim të gjerë për përfshirjen e fëmijëve në procedurat gjyqësore civile, administrative dhe penale në 28 Shtetet Anëtare të BE-sënë të cilin mblodhi dhe bashkoi të gjitha statistikat e disponueshme si dhe publikoi një raport sintetik të politikave dhe 29 raporte për shtetet, për secilën nga tre fushat e drejtësisë (Përmbledhje e panoramave kontekstuale për përfshirjen e fëmijëve në procedurat gjyqësore penale në 28 Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, Bashkimi Evropian 2014)

⁹ Shih fusnotën 6 për referenca

profesionistët, por nuk është gjithmonë pa vështirësi. Ky bashkëpunim kërkon angazhim dhe investim nga të gjitha institucionet e përfshira. Duhet të vendosen baza të forta për një organizim të efektshëm dhe që funksionon mirë, i cili t'u bëjë të mundur të gjitha organeve të punojnë së bashku në mënyrë të bashkërenduar. E rëndësishme është që bashkëpunimi duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të drejtat, nevojat dhe interesat e fëmijëve të jenë në qendër të vëmendjes.

Duke u mbështetur në legjislationin dhe orientimet ndërkombëtare dhe evropiane dhe në modelin Barnahus¹⁰, ky dokument parashtron dhjetë standarde të praktikave të mira, “European Barnahus Standards”, për shërbime shumëdisiplinore dhe ndërinstitutionale për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës në Evropë, të përshtatura për të miturit. Ky dokument është përmbledhje e versionit të plotë të udhëzuesit ku parashtrihen standardet.¹¹

Qëllimi kryesor i standardeve është të krijohet një kornizë të përbashkët operacionale dhe organizative që të promovojë praktikat që parandalojnë (ri)traumatizimin¹² dhe janë në pajtim me të drejtat e fëmijëve për mbrojtje, ndihmë dhe drejtësi të

¹⁰ Modeli Barnahus, i diskutuar me detaje në kapitullin 2, njihet si shërbim shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional pararojë për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës. Shih fusnotën 12 për referenca.

¹¹ Lind Haldorsson, Olivia (2017) European Barnahus Quality Standards: Guidance for Multidisciplinary and Interagency Response to Child Victims and Witnesses of Violence www.barnahus.eu/standards

¹² Këtu i referohemi traumatizimit të mundshëm të fëmijës dhe/ose ritraumatizimit, i cili është procesi i rikthimit në gjendje traume të shkaktuar nga një ngjarje, siç janë seancat gjyqësore ose disa intervista njëra pas tjetrës. Riviktimizimi i referohet procesit të viktimizimit në mënyrë të përsëritur.

përshtatur për fëmijët, duke siguruar ndërkohë dëshmi të vlefshme për proceset gjyqësore.

Standardet janë përmbledhje e parimeve dhe aktiviteteve ndërsektoriale, e funksioneve thelbësore dhe dispozitave institucionale që bëjnë të mundur ndërhyrje të përshtatura për fëmijët, të efektshme dhe të bashkërenduara ku përfshihen: 1.1 Interesi më i lartë i fëmijës; 1.2 Të drejtat e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për të marrë informacion; 1.3 Parandalimi i vonesave të pajustificuara; 2. Organizimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional; 3. Grupet e synuara; Mjedis i përshtatshëm për fëmijët; 5. Planifikimi ndërinstitutional dhe menaxhimi i çështjeve; 6. Intervistat mjekoligjore; 7. Kontrolli mjekësor; 8. Shërbime terapeutike; 9. Ngritja e kapaciteteve dhe 10. Parandalimi: shkëmbimi i informacionit dhe ndërtimi i kompetencave të jashtme.

Duke vepruar në përputhje me standardet, (ri) traumatizimi mund të parandalohet duke u siguruar që praktikat dhe vendimet të bazohen te interesi më i lartë i fëmijës; që e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar të përmbushet pa intervista të përsëritura; që fëmija të intervistohet dhe mbështetet nga profesionistë të specializuar dhe kompetentë; që intervistat të kryhen në një mjedis shumëdisiplinor dhe të përshtatur për fëmijën, duke ofruar mbështetje të përshtatshme për fëmijën dhe kujdestarët e tij pa vonesa të pajustificuara dhe që fëmija të mos jetë i detyruar të paraqitet në gjykatë.¹³

¹³ Standardet evropiane për një Barnahus nxitin qasjen gjithëpërfshirëse ku përfshihen: të drejtat e fëmijëve për t'u dëgjuar dhe për të marrë informacion; bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional me qëllim që të shmangët ritraumatizimi dhe të garantohen rezultate në interesin e lartë të fëmijës; shërbimet gjithëpërfshirëse dhe të arritshme që plotësojnë nevojat individuale dhe komplekse

Standardet frymëzohen nga puna e mëparshme në këtë fushë, përfshirë Standardet për mbrojtjen e akredituar të fëmijëve/Qendrat e mbrojtjes të Aleancës Kombëtare të Fëmijëve¹⁴ në SHBA dhe nga kriteret e zhvilluara për vlerësimin e Barnahus në Suedi¹⁵. Ato janë zhvilluar me kontributin e ekspertëve dhe profesionistëve me përvojë nga Barnahus dhe qendrat e përshtatura për fëmijë, të cilët punojnë me fëmijë viktime dhe dëshmitarë të dhunës në Evropë. Standardet bazohen në gjërat që kanë dhënë prova se funksionojnë dhe kanë vërtet vlerë të shtuar për fëmijën, familjen dhe profesionistët që punojnë së bashku¹⁶.

të fëmijës dhe të familjes ose kujdestarëve joabuzues; sigurimi i standardeve të larta profesionale, trajnimi dhe burimet e mjaftueshme për personelin që punon me fëmijë dëshmitarë dhe viktime të dhunës dhe parandalimi i dhunës, për shembull përmes rritjes së ndërgjegjësimit. Shih vizionin e PROMISE, www.barnahus.eu/publications

¹⁴ Standardet për Anëtarët e Akredituar (Aleanca Kombëtare e Fëmijëve, 2017) <http://www.nationalchildrensalliance.org/sites/default/files/downloads/NCA-Standards-for-Accredited-Members-2017.pdf>

¹⁵ Landberg, Åsa and Svedin, Carl Göran (2013). Inuti ett Barnahus, A quality review of 23 Swedish Barnahus. Stockholm, Rädda Barnen English: http://www.barnafrid.se/custom/uploads/2016/10/Inuti-ett-Barnahus_ENG.pdf

¹⁶ Standardet janë zhvilluar me kontributin verbal dhe me shkrim të grupit të ekspertëve të projektit PROMISE me ekspertë p.sh. nga Barnahus Islandë, Barnahus Linköping (Suedi), Barnahus Stokholm (Suedi), Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve në Zagreb (Kroaci), MDCK në Haarlem (Holandë), Universiteti Linköping (Suedi) dhe Programi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Universitetin e Iowa-s. U krye një konsultim i gjerë për standardet dhe ky dokument u hartua përmes bisedave dhe një sondazhi me shkrim me Ministritë/ autoritetet dhe/ose përfaqësuesit e shërbimeve nga Bullgaria, Qipro, Estonia, Finlanda, Irlanda, Gjermania, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Britania e Madhe (Anglia dhe Skocia).

Është me rëndësi të theksohet se standardet mishërojnë një model për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara në legjislacionin evropian dhe ndërkombëtar. Në përgjithësi, legjislacioni ndërkombëtar dhe evropian kërkon që të respektohen parimet e përgjithshme, si interesi më i lartë i fëmijës dhe pjesëmarrja e fëmijës. Legjislacioni përmban edhe disa dispozita specifike në lidhje me proceset kryesore si intervistat me fëmijët viktime të dhunës dhe ndihma që u jepet. Standardet përkojnë me mënyrën si mund të zbatohen këto dispozita ligjore në praktikën e përditshme përmes aktiviteteve ndërinstitucionale dhe funksioneve thelbësore të Barnahus. Standardet trajtojnë edhe dispozita institucionale të cilat shërbejnë si bazë për praktikën dhe, pavarësisht se këto rregullohen më rrallë nga vetë legjislacioni, ato trajtohen në udhëzimet zyrtare për zbatimin e këtyre ligjeve¹⁷. Me pak fjalë, dispozitat institucionale përshkruajnë mënyra pune që u mundësojnë ekipeve të maksimizojnë aftësitë e tyre për të përmbushur dispozitat ligjore.¹⁸

¹⁷ Standardet janë në pajtim me udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatur për fëmijët dhe promovojnë elementet kryesore të drejtësisë së përshtatur për fëmijët (e arritshme (p.sh. standardet 3 dhe 4), e përshtatur me moshën (p.sh. standardi 1.1, 5, 6), e shpejtë (p.sh. standardi 1-3, 5, 6), e kujdesshme (p.sh. standardi 5 dhe 6), e përshtatur dhe e përqendruar te nevojat e fëmijës (p.sh. standardi 1.1-1.3, 5, 6), respektuese e së drejtës për një proces të rregullt ligjor (p.sh. standardi 6), respektuese e së drejtës për të marrë pjesë dhe për të kuptuar procedurat (p.sh. standardi 1.2), respektuese e së drejtës për jetë private dhe familjar (p.sh. standardi 1.1, 3, 4), respektuese e së drejtës për integritet dhe dinjitet (p.sh. standardi 1.1, 3, 4)).

¹⁸ Tabela në kapitullin IV ofron një përmbledhje të detyrimeve ligjore dhe udhëzimeve ndërkombëtare të vëna në jetë nga standardet. Ka referenca edhe për dispozitat përkatëse ligjore dhe udhëzimet në të gjitha profilet që përshkruajnë standardet në kapitullin 3. Shih edhe O'Donnell, Rebecca (2017) PROMISE Compendium of Law and Guidance: European and Inter-national Instruments

Standardet janë formuluar për të siguruar transferueshmërinë dhe përshtatshmërinë, duke ditur se ato do të zbatohen në kontekste të ndryshme politike, ligjore, gjyqësore, socioekonomike dhe kulturore.

19

Gjatë miratimit të standardeve, duhet të theksohet se është e rëndësishme të diskutohet dhe vlerësohet vazhdimisht kuadri organizativ dhe kryerja e shërbimit. Treguesit bashkëngjitur standardeve ofrojnë shembuj të informacioneve që zbulojnë masën në të cilën janë përmbushur standardet dhe mund të mbështesin rishikimin e politikave dhe praktikave. Vlerësimi ofron edhe mundësi të rëndësishme për të siguruar që kërkimet, udhëzimet, ligjet dhe përvojat e reja të mbështesin praktikën dhe strukturimin e shërbimit. Duhet bërë përpjekje të veçanta për të siguruar që fëmijët të dëgjohen dhe që pikëpamjet e tyre të informojnë strukturimin e shërbimit.²⁰

concerning Child Victims and Witnesses of Violence, Stockholm, PROMISE Project Series www.barnahus.eu/publications

¹⁹ Wenke, Daja and Heiberg, Turid (2017) Enabling Child-sensitive Justice: The Success Story of the Barnahus Model and its Expansion in Europe, Stockholm, The PROMISE Project Series, www.barnahus.eu/publications

²⁰ Është zhvilluar një instrument verifikimi për të ofruar një mjet të thjeshtë për të vlerësuar se ku e shohin veten shërbimet në procesin e krijimit të një modeli Barnahus që të trupëzojë standardet e paraqitura në këtë dokument. Instrumenti i verifikimit mund të shkarkohet nga faqja e internetit e PROMISE www.barnahus.eu/publications

Ky dokument zbaton përkufizimin e dhunës të përcaktuar në nenin 19 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës: "çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual".

"Fëmijë" këtu përkufizohet sipas Neni 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës: "çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç".

Për të mësuar më shumë

Versioni i plotë i këtij udhëzuesi përmban shembuj nga praktika me vlerë nga Barnahus të shquara dhe nga shërbime të përshtatura për fëmijë në Evropë, duke treguar sesi lloje të ndryshme shërbimesh dhe kontekstesh kombëtare kanë krijuar qasje të ndryshme duke iu përbajtur parimeve themelore, aktiviteteve dhe dispozitave të përshkuara në standarde.²¹

Shihni gjithashtu *Interagency Agreement Template and Guidance* që mund t'ju ndihmojë të thelloheni te elementet thelbësore për zbatimin e standardeve në kontekstin tuaj specifik. Qëllimi i udhëzuesit dhe modelit është të frymëzojë dhe orientojë në hartimin e një marrëveshjeje ndërinstitucionale e cila zyrtarizon bashkëpunimin e ekipeve shumëdisiplinore dhe ndërinstitucionale (ShDNI) të agjencive të përfshira në Barnahus.²²

²¹ Lind Haldorsson, Olivia (2017) European Barnahus Quality Standards: Guidance for Multidisciplinary and Interagency Response to Child Victims and Witnesses of Violence www.barnahus.eu/standards

²² Lind Haldorsson, Olivia (2019) Standardi 2. Bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitucional: Marrëveshja ndërinstitucionale: Modeli dhe orientimet www.barnahus.eu/standards

Modeli Barnahus

Barnahus (në islandisht "shtëpi për fëmijë") njihet si model udhëheqës, të përshtatur me të miturit, shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional që u përgjigjet fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës.²³ Qëllimi i Barnahus është t'i ofrojë çdo fëmije një përgjigje të bashkërenduar dhe të efektshme dhe të parandalojë (ri) traumatizimin gjatë procedurave hetimore dhe gjyqësore.

Një rol kyç i Barnahus është të ndihmojë në prodhimin e provave të vlefshme për procedurat gjyqësore duke nxitur komunikimin nga ana e fëmijës, në mënyrë që fëmija të mos paraqitet në gjykatë nëse çështja ndiqet penalisht.²⁴

Gjatë kryerjes së këtij roli, Barnahus ofron një qasje unike, duke nxitur bashkëpunimin midis autoriteteve përkatëse dhe agjencive si policia, shërbimet sociale, ato për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet e shëndetit fizik dhe mendor dhe prokuroria në një mjedis të përshtatur për fëmijët. Barnahus luan rol të rëndësishëm edhe në

²³ Wenke, Daja and Heiberg, Turid (2017) Enabling Child-sensitive Justice: The Success Story of the Barnahus Model and its Expansion in Europe, Stockholm, The PROMISE Project Series, www.barnahus.eu/standards, fq. 4. Shih edhe thirrjen EC REC-RDAP-CHIL-AG-2016 që thekson modelin Barnahus: "propozimet duhet të synojnë që të garantojnë një përgjigje të përshtatur për fëmijët kundër dhunës ndaj fëmijëve. Kjo përgjigje duhet të jetë ndërinstytucionale, shumëdisiplinore, gjithëpërfshirëse dhe, kur është e mundur, në një qendër të vetme (modeli Barnahus /i shtëpisë për fëmijë)."

²⁴ Në shumë vende, fëmijët më të rritur, zakonisht ata mbi 15 vjeç, duhet të paraqiten në gjykatë, edhe kur është zhvilluar intervista në Barnahus.

rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive për dhunën ndaj fëmijëve me palët më të rëndësishme të interesit.²⁵

Një karakteristikë kryesore e Barnahus-eve nordike është se ato janë pjesë përbërëse e autoriteteve kombëtare, si shërbimet sociale, sistemet shëndetësore, ato të mbrojtjes së fëmijëve dhe sistemi gjyqësor. Në kontekste të ndryshme kombëtare janë bërë marrëveshje të ndryshme institucionale për të arritur këtë objektiv. Për shembull, në disa vende, Barnahus-et janë integruar si funksion i shërbimeve sociale dhe autoriteteve të mbrojtjes së fëmijëve, ndërsa në vende të tjera janë pjesë e sistemit shëndetësor ose e forcave të rendit. Megjithatë, në çdo rast ato parashikojnë bashkëpunimin shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional në një mjedis të përshtatur për fëmijët. Në disa vende, në Barnahus intervistën me fëmijën e kryen një oficer policie, ndërsa në vende të tjera intervistën e kryen një specialist i fëmijëve, për shembull një psikolog ose një punonjës social. Sidoqoftë, të gjitha strukturat Barnahus sigurohen që personi që interviston fëmijën të trajnohet posaçërisht për intervistat mjekoligjore me fëmijët, që për intervistat mjekoligjore të përdoren

²⁵ Barnahus-et e vendeve nordike kanë role të ndryshme: në Danimarkë: të ndihmojë shërbimet vendore bashkiake të mbrojtjes së fëmijëve; në Islandë: të bashkërendojë hetimet paralele penale dhe të mbrojtjes së fëmijëve; në Norvegji: të ndihmojë intervistën hetimore të policisë; në Suedi: të bashkërendojë hetimet paralele penale dhe ato të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës (Bakketeig, Elisiv (2016). Modeli Barnahus në vendet nordike. Punim i prezantuar në Konferencën rajonale dhe vizitën studimore të PROMISE, në Linköping 28-29 nëntor 2016. Bazuar te Johansson, Susanna, Kari Stefansen, Anna Kaldal & Elisiv Bakketeig (in press, 2017): Implementing the Nordic Barnahus model: Characteristics and local adaptations. In Johansson, S., Stefansen, K., Kaldal, A. & Bakketeig, E. (red.). Collaborating against child abuse: Exploring the Nordic Barnahus Model.)

protokolle të bazuara në prova dhe që intervista të vëzhgohet nga një ekip shumëdisiplinor nga një dhomë ngjitur me dhomën e intervistës.

Në Evropë ka edhe disa modele të tjera shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale të ngjashme me modelin Barnahus. Këto shërbime zakonisht kanë shkallë të ndryshme përfshirjeje të autoriteteve të shëndetit kombëtar, të shërbimeve sociale, të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe/ose të autoriteteve vendore.²⁶

Dallim tjetër i rëndësishëm midis qasjes nga Barnahus dhe shërbimeve të tjera shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale ndonjëherë qëndron në njohjen zyrtare të kësaj qasjeje brenda sistemit gjyqësor. Në varësi të sistemit gjyqësor dhe ndonjëherë në varësi të qasjes dhe qëndrimit të gjykatësve, fëmijët në disa vende evropiane ende duhet të paraqiten në gjykatë edhe atëherë kur ekzistojnë struktura për të dëgjuar fëmijët në mjedis shumëdisiplinor të përshtatur për fëmijë. Kjo gjë mund të ndodhë edhe aty ku shërbimet janë bërë pjesë e autoriteteve kombëtare dhe/ose vendore, për shembull pjesë e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve ose të sistemit shëndetësor.

Modeli i Children's Advocacy Centre (CAC)²⁷ në SHBA dhe modeli Barnahus kanë të njëjtin qëllim të përgjithshëm: parandalimin e (ri)traumatizimit dhe sigurimin e një përgjigjeje shumëdisiplinore për fëmijën. Policia dhe prokuroria janë të përfshira, por në modelin CAC, shërbimi nuk është i përfshirë zyrtarisht në sistemin gjyqësor. Zakonisht fëmija duhet të paraqitet në gjykatë nëse bëhet një

²⁶ Shih hartën e palëve të interesuara PROMISE, www.barnahus.eu/publications

²⁷ Për më shumë informacion rreth Children's Advocacy Centers, vizitoni <http://www.nationalchildrensalliance.org/cac-model>

aktakuzë, pasi në të kundërt, në varësi të ligjit të shtetit, dëshmia nuk konsiderohet e marrë në kushtet e "procesit të rregullt ligjor". Sidoqoftë, CAC përgatit dhe mbështet fëmijën për procedurat gjyqësore dhe luan rol të rëndësishëm në zvogëlimin e numrit të rasteve që fëmija duhet të rrëfejë përvojën e tij ose të saj, duke siguruar që të ketë një përgjigje të koordinuar nga shërbime të ndryshme për secilin fëmijë.

Llojet e tjera të qendrave shumëdisiplinore të përshtatura për fëmijët zakonisht kanë të përbashkët qëllimin për uljes së (ri) traumatizimit dhe ofrojnë përgjigje shumëdisiplinore, por nuk kanë përfshirje sistematike të të gjitha autoriteteve përkatëse kombëtare dhe vendore, përfshirë policinë dhe prokurorinë. Disa prej këtyre shërbimeve janë integruar në sistemin shëndetësor kombëtar ose vendor, në shërbimet sociale ose sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Janë krijuar edhe të tjerë që veprojnë si agjenci të pavarura dhe përfshihen në bashkëpunim ndërinstytucional në mënyrë më pak formale.

Disa vende evropiane kanë miratuar qasje shumëdisiplinore dhe ndërinstytucionale për mbrojtjen e fëmijëve, pa ofruar shërbime të përbashkëta në një mjedis të përshtatur për fëmijë. Teksa disa nga standardet mund të jenë të zbatueshme për disa elemente të marrëveshjeve të tilla, ky udhëzues promovon fuqimisht një qasje unike, ku fëmijës i ofrohet përgjigje e koordinuar në një mjedis të përshtatur për fëmijë. Në fakt, kjo konsiderohet si kusht kryesor për të parandaluar (ri)traumatizimin dhe sigurimin e dëshmisë të fëmijës.

Modeli në faqen vijuese ilustron se si është ngritur Barnahus në Islandë. Udhëzuesi i plotë përfshin modele Barnahus dhe shërbime të ngjashme në vende të tjera.

BARNAHUS Islandë

Roli kryesor i Barnahus është të bashkërendojë

hetimet penale dhe të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve

Bashkërendon bashkëpunimin ndërinstytucional, sidomos në mbledhjen e provave; Kryen intervista mjekoligjore duke zbatuar protokolle të bazuara në prova; Ofron konsulta dhe këshillim për çështje individuale në bashkëpunim me institucionet partnere; Ofron vlerësim dhe terapi të specializuara për fëmijët viktima të dhunës; Ofron konsulta dhe këshillim për prindërit dhe kujdestarët e tjerë joabuzues;

Ofron konsulta dhe këshillim për shërbimet vendore të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbime të tjera sipas rastit.

INTERVISTA MJEKOLIGJORE - PROFESIONISTËT E SHËNDETTIT MENDOR TË SPECIALIZUAR NË INTERVISTAT MJEKOLIGJORE

Dëshmitë në gjykatë:

Përgjegjës për marrjen e dëshmisë së fëmijës nën kujdesin e gjyqtarit dhe nën vëzhgimin e avokatëve të mbrojtjes, të prokurorisë, policisë, shërbimeve vendore të mbrojtjes së fëmijëve dhe të avokatit të fëmijës

Shërbejnë si ndërmjetës për pyetjet e gjyqtarit, mbrojtjes dhe të tjerëve sipas rastit
Dëshmitë regjistronen për përdorim gjatë seancave gjyqësore, në rast se do të ngrihen akuzat formale

Intervistat hulumtuuese:

Nxjerrja e rrëfimit të fëmijës, nëse është e mundur, në rastet kur rrëfimi mungon ose i pagartë, me kërkesë të shërbimeve vendore të mbrojtjes së fëmijëve
Marrja e dëshmisë së fëmijës në rastet kur autori i dyshuar i veprës penale është nën moshën e përgjegjësisë penale, me kërkesë të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve

EKZAMINIMI MJEKËSOR - PERSONELI I SPECIALIZUAR MJEKËSOR

Kontrollet mjekësore kryhen me kërkesë të policisë, të shërbimeve vendore të mbrojtjes së fëmijëve, të fëmijës ose prindërve të tij
Përgjegjës për ekzaminimin janë një mjek pediatër me përvojë, një gjinekolog dhe një infermiere e trajnuar, personeli i Spitalit Universitar të Islandës
Vizitat mjekësore mjekoligjore akute kryhen në Spitalin Universitar

VLERËSIMI, TERAPIA, MBËSHETJA - PROFESIONISTI I SPECIALIZUAR I SHËNDETTIT MENDOR

Vlerësimi dhe trajtimi

Përgjegjës për vlerësimin e shëndetit mendor në bazë të instrumenteve dhe pyetësorëve të miratuar

Përgjegjës për trajtimin e shëndetit mendor me terapi të bazuara në prova

Siguron qasje në trajtim

Siguron terapi në mjedisin e shtëpisë së fëmijëve viktima jashtë zonave urbane

Mbështetje për prindërit joabuzues

Sipas rastit, ofron konsulta dhe këshillim për prindërit/kujdestarët dhe vëllezërit e motrat joabuzues

DETYRA TË TJERA - PERSONELI I BARNAHUS

Konsultime dhe këshillim sipas kërkesës për shërbimet vendore të mbrojtjes së fëmijëve

Bashkërendim i mbledhjeve për menaxhimin e çështjes dhe menaxhimin i çështjes para dëshmisë në gjykatë

Takime ndërinstytucionale për konsultime para referimit në Barnahus

Dorëzim të raporteve në gjykatë për rastet me ndjekje penale

Regjistrimi i çështjeve dhe mbajtja e arkivave

Edukimi, trajnimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

Nga pikëpamja formale bën pjesë në institucionin qeveritar për mbrojtjen e fëmijëve. Institucioni qeveritar siguron financimin, menaxhimin financiar dhe të personelit. Institucioni qeveritar ofron orientime ligjore dhe udhëzime të tjera profesionale si dhe është përgjegjës për çështjet administrative në bashkëpunim me gjykatat, prokurorinë e rrethit, policinë, spitalin universitar dhe zyrën vendore të mbrojtjes së fëmijëve të cilët janë partnerë të Barnahus

Kriteret e përbashkëta kryesore për Barnahus

Barnahus ofron mjedis të sigurt dhe të përshtatur për fëmijët, duke bashkuar të gjitha shërbimet përkatëse nën një çati.

1. Intervistat mjekoligjore kryhen sipas një protokollit të bazuar në prova;
2. Vlefshmëria e dëshmisë së rrëfyer nga fëmija që ka vlerë prove garantohet nga dispozitat e duhura në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor. Qëllimi është të parandalohet që fëmija të përsërisë deklaratën e tij gjatë procedurave gjyqësore nëse ngrihet një aktakuzë;
3. Kryhet vlerësimi mjekësor për qëllime hetimore mjekoligjore si dhe për të siguruar mirëqenien dhe rikuperimin fizik të fëmijës;
4. Jepet mbështetje psikologjike dhe shërbime terapeutike afatshkurtra dhe afatgjata për traumën e fëmijës, të anëtarëve të familjes dhe të kujdestarëve jo abuzues;
5. Bëhet vlerësim i nevojave për mbrojtje të viktimës dhe fëmijëve të tjerë të familjes, nëse ka, dhe sigurohet ndjekja në vazhdimësi.

Për të mësuar më shumë

Çdo kontekst kombëtar do të ketë mundësitë dhe sfidat e veta specifike për të krijuar një model Barnahus ose të ngjashëm. Versioni i plotë i këtij udhëzuesi përfshin ilustrime të pesë modeleve të ndryshme dhe shembuj të praktikave më të mira, të cilat tregojnë sesi kontekste të ndryshme kombëtare kanë krijuar larmi dhe origjinalitet në ngritjen dhe funksionimin e e Barnahus-eve dhe shërbimeve të ngjashme të përshtatura për fëmijë, duke zbatuar njëkohësisht parimet dhe vlerat thelbësore që këto standarde përfaqësojnë.²⁸

Shihni gjithashtu *Interagency Agreement Template and Guidance* që mund t'ju ndihmojë të theloheni te elementet thelbësore për zbatimin e standardeve në kontekstin tuaj specifik.²⁹

²⁸ Lind Haldorsson, Olivia (2017) European Barnahus Quality Standards: Guidance for Multidisciplinary and Interagency Response to Child Victims and Witnesses of Violence www.barnahus.eu/standards

²⁹ Lind Haldorsson, Olivia (2019) Standardi 2. Bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional: Marrëveshja ndërinstytucionale: Modeli dhe orientimet www.barnahus.eu/standards

Standardet Barnahus

Ky kapitull paraqet standardet evropiane për një Barnahus. Standardet përbëhen nga parime dhe aktivitete ndërsektoriale, funksione bazë dhe dispozita institucionale të cilat mundësojnë një praktikë efektive, bashkëpunuese dhe të përshtatur për fëmijët. Në shumicën e rasteve, standardi përbëhet nga lidhja e disa elementeve të standardeve. Për shembull, standardi i lidhur me grupin e synuar përfshin dy elemente: "përkufizimin gjithëpërfshirës dhe të gjerë" dhe "mosdiskriminimin".

Së bashku, standardet ofrojnë një kornizë praktike për palët që dëshirojnë të krijojnë dhe drejtojnë shërbime që respektojnë parimet thelbësore dhe tiparet e modelit Barnahus. Standardet mund të përdoren si frymëzim dhe mbështetje për zhvillimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ndërsektoriale të shërbimit, të funksioneve të tij thelbësore dhe të strukturës organizative. Standardet ofrojnë edhe orientim për ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve si dhe punën parandaluese, si shkëmbimi i informacionit dhe ndërtimi i njohurive me palë të rëndësishme.

Përshkrimi dhe logjika e standardeve dhe e treguesve të sugjeruar, legjislacioni dhe udhëzimet përkatëse si dhe mjetet përkatëse janë përmbledhur në tabelat që përmbajnë "[Profilin standard](#)". [Celësi i leximit të "Profilin të standardit", i cili përshkruan përmbajtjen, mund të gjendet në faqen 21.](#)

Standardet janë të transferueshme dhe mund t'u përshtaten sistemeve dhe proceseve të ndryshme kombëtare që kanë të bëjnë

me shërbimet sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve³⁰, me kujdesin shëndetësor, me hetimet penale dhe me procedurat gjyqësore.

Standardi i parë përmban tre aktivitete ndërsektoriale të zbatueshme për të gjithë procesin, duke nisur nga raporti fillestar deri te procesi gjyqësor: vendosja e interesit më të lartë të fëmijës në qendër të praktikës dhe vendimmarrjes (1.1), garantimi i respektimit të të drejtës së fëmijëve për t'u dëgjuar dhe për t'u informuar (1.2) dhe parandalimi i vonesave të pajustificuara (1.3).

Standardet 2-4 kanë të bëjnë me dispozitat institucionale dhe strukturat organizative, për shembull, për të garantuar një mjedis të përshtatur për fëmijët. Këto standarde janë të rëndësishme për pjesët e procesit që ndodhin në Barnahus.

Standardet 5-10 merret me funksionet thelbësore dhe aktivitetet specifike që ndërmerr një Barnahus, për shembull, me menaxhimin e çështjeve nga një grup institucionesh, intervistat mjekoligjore ose ekzaminimin mjekësor.

Për të mësuar më shumë

Versioni i plotë i këtij udhëzuesi përfshin disa praktika të mira që ilustrjnë si janë zbatuar standardet në Barnahus-et me përvojë dhe qendra të tjera të përshtatura për fëmijë viktime dhe dëshmitarë të dhunës në Evropë. Ky version përmban edhe instrumente, ekstrakte nga ligjet dhe udhëzime që ofrojnë të dhëna të mëtejshme në zbatimin e standardeve. Për më tepër, ai përmban shembuj ilustrues të procesit që

³⁰ Këtu përfshihen vlerësimet e mbrojtjes së fëmijës, të cilat janë vlerësime objektive të rrezikut që fëmija të ekspozohet ndaj dhunës së mëtejshme nga prindi (prindërit) / kujdestari (kujdestarët). Këtu bazohen vendimet në lidhje me ndërhyrjet e vazhdueshme në familje dhe/ose largimin e fëmijës nga shtëpia.

nga raporti fillestar deri në procesin gjyqësor dhe rolin e Barnahus-eve dhe shërbimeve të përshtatura për fëmijë në disa shtete.³¹ Shihni gjithashtu *Interagency Agreement Template and Guidance*, që mund t'ju ndihmojë të thelloheni te elementet thelbësore për zbatimin e standardeve në kontekstin tuaj specifik.³²

³¹ Lind Haldorsson, Olivia (2017) European Barnahus Quality Standards: Guidance for Multidisciplinary and Interagency Response to Child Victims and Witnesses of Violence www.barnahus.eu/standards

³² Lind Haldorsson, Olivia (2019) Standardi 2. Bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstucional: Marrëveshja ndërinstucionale: Modeli dhe orientimet www.barnahus.eu/standards

Çelësi për leximin e Profileve

Standarde

Cili është standardi?

Duke u mbështetur në legjislacionin e OKB-së, BE-së, Këshillit të Evropës dhe modelit Barnahus, ky dokument parashtron dhjetë standarde të praktikave të mira për shërbime të efektshme dhe të përshtatura për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës. Qëllimi thelbësor i standardeve është të sigurohet një kuadër brenda të cilit parandalohet (ri)traumatizimi, sigurohet dëshmia e vlefshme për gjykatën si dhe respektohet e drejta e fëmijëve për mbrojtje, ndihmë dhe drejtësi të përshtatur për fëmijët.

Standardet mbështesin zbatimin e detyrimeve ligjore në rang evropian dhe ndërkombëtar dhe të udhëzimeve zyrtare për zbatimin e legjislacionit dhe politikës përkatëse.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Referencat ndaj detyrimeve ligjore ndërkombëtare dhe evropiane: standardet dhe treguesit mbajnë me vete detyrimet ligjore të përmendura në këtë katror. Këto detyrime ligjore, të kategorizuara në Përmbledhjen e Legjislacionit dhe Udhëzimeve nga PROMISE, bazohen në dispozita specifike të instrumenteve ligjore ndërkombëtare dhe evropiane. [Tabela në fund të këtij dokumenti përfshin një listë të dispozitave dhe instrumenteve ligjore me rëndësi të veçantë për standardet përkatëse dhe detyrimet ligjore.](#)

Referimi të udhëzuesit: argumentet specifike për arsyen pse duhet të përmbushet standardi mbështeten në udhëzimet zyrtare të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe organe të tjera si Këshilli i Evropës.

Kërkimi dhe përvoja: standardet i vendosin nevojat e fëmijëve në qendër të vëmendjes, me qëllimin e përgjithshëm për të garantuar praktika të efektshme dhe të përshtatura për të gjithë fëmijët viktime ose dëshmitarë të dhunës. Prandaj, standardet janë zhvilluar duke marrë parasysh kërkimet dhe përvojën e ekipeve shumëdisiplinore dhe ndërinsticionale për qasjet që kanë dhënë prova se funksionojnë dhe kanë ndikim pozitiv në mirëqenien e fëmijës viktime ose dëshmitar të dhunës dhe anëtarëve joabuzues të familjes së tyre.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Treguesit mund të ndihmojnë të përcaktohet nëse një shërbim zbaton një standard të caktuar gjatë punës së tij dhe në cilën shkallë e zbaton. Treguesit mbështeten në legjislacionin dhe orientimet ndërkombëtare dhe rajonale dhe, njësoj si standardet, mund të përshtaten për të pasqyruar pjesën më të madhe të mjediseve ligjore, politike, socio-ekonomike dhe kulturore.

Shumica e indikatorëve janë tregues të lidhur me politikat, duke treguar ekzistencën e politikave ose procedurave përkatëse, siç janë marrëveshjet zyrtare ndërinsticionale. Treguesit mund të vlerësojnë edhe zgjidhjet fizike ose teknike, të tilla si ekzistenca e një dhome intervistash e cila lidhet me zë dhe figurë me një dhomë tjetër brenda shërbimit. Të gjithë treguesit kërkojnë informacion

përshkrues, për shembull, për politikat, procedurat, protokollet, zgjidhjet fizike dhe teknike ekzistuese.

Në disa raste, mund të përdoren treguesit sasiorë për të plotësuar treguesit e politikës/procedurës, si për shembull numri i ditëve ndërmjet zbulimit ose raportimit të dyshimit dhe intervistës mjekoligjore (vonesë e pajustificuar). Treguesit sasiorë kërkojnë mbledhjen e të dhënave specifike me vlerë numerike.

Është e rëndësishme të theksohet se treguesit japin shembuj treguesish dhe provash. Çdo shërbim duhet të investojë kohë në zhvillimin e një grupi të plotë treguesish për monitorimin e performancës. Treguesit dhe llojet e provave të propozuara këtu mund të shërbejnë si orientim dhe frymëzim.

Është e rëndësishme të theksohet edhe se treguesit lidhen rreptësisht me operacionet dhe performancën e shërbimit dhe nuk japin informacion për ndikimin afatshkurtër ose afatgjatë dhe/ose rezultatet të fëmijët që përfitojnë nga shërbimet.

Për të mësuar më shumë

Versioni i plotë i këtij udhëzimi referon mjetet praktike, orientimet, politikat, modelet dhe burimet e tjera që mund të mbështesin zbatimin e standardit, përfshirë edhe *Interagency Agreement Template and Guidance*.³³

³³ Lind Haldorsson, Olivia (2017) European Barnahus Quality Standards: Guidance for Multidisciplinary and Interagency Response to Child Victims and Witnesses of Violence www.barnahus.eu/standards

Standardi 1: Parimet kyçe dhe aktivitetet ndërsektorale

Standardi 1 përbëhet nga tre parime kryesore, të cilat informojnë praktikën shumëdisiplinore dhe vendimmarrjen në Barnahus.

Parimet janë bërë operative përmes aktiviteteve ndërsektorale që zbatohen si pjesë përbërëse e funksioneve përkatëse bazë të parashikuara në standardet 5-10.

Aktivitetet ndërsektorale mundësohen nga dispozitat institucionale dhe strukturat organizative që gjenden në standardet 2-4.

Parimet kryesore dhe aktivitetet ndërsektorale mishërojnë dispozitat thelbësore të legjislacionit ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar, përfshirë nenin 3 dhe 12 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.³⁴ Ato janë thelbësore për të parandaluar (ri)traumatizimin, gjë që përbën synimin kryesor për një Barnahus.

Parimet kryesore dhe aktivitetet ndërsektorale të shtjelluara në Standardin 1 përqendrohen te:

- garancia që në qendër të praktikës dhe vendimmarrjes të vendoset interesi më i lartë i fëmijës (standardi 1.1);

³⁴ Kuadri i plotë i standardeve kontribuon në zbatimin e neneve 19 dhe 6 të KDF-së (e drejta për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin). Mosdiskriminimi (neni 2 i KDF-së) trajtohet më poshtë nën standardin 3 si një aspekt përbërës në përcaktimin e grupit të synuar të shërbimit.

- respektimi i së drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar pa shkaktuar (ri)traumatizim edhe nëpërmjet dhënies së informacionit të duhur në çdo kohë (standardi 1.2) dhe;
- garancia që proceset e mbrojtjes, ndihmës dhe drejtësisë ndërmerren në kohën e duhur (standardi 1.3).

Mbrojtja e fëmijëve është parim thelbësor dhe aktivitet ndërsektorial i cili trajtohet posaçërisht në standardet 2 dhe 10.

Standardi 1.1 Interesi më i lartë i fëmijës

Cili është standardi?

Interesi më i lartë i fëmijës: Interesi më i lartë të fëmijës është konsiderata kryesore në të gjitha veprimet dhe vendimet në lidhje me fëmijën dhe familjen/personat kujdestarë/personat mbështetës jo abuzues.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Detyrimet ligjore ndërkombëtare: Interesi më i lartë i fëmijës (Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, neni 3) është një e drejtë, një parim i përgjithshëm dhe rregull procedural. Është i rëndësishëm për zbatimin e Konventës në tërësi, bashkë me të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga dhuna. Neni 3 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës kërkon që palët të mendojnë me kujdes ndikimin e veprimeve të tyre të fëmijët, për t'u siguruar që konsiderata parësore është interesi më i lartë i fëmijës. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (CRC) thekson se neni 3, paragrafi 3, duhet respektuar kur fëmijëve u ofrohen të gjitha shërbimet dhe strukturat.

Prandaj, shërbimet për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës duhet të garantojnë që vendimet për veprimet e duhura bazohen në vlerësimin e interesit më të lartë të çdo fëmije. KDF-ja pranon që koncepti i interesit më të lartë të fëmijës është "kompleks dhe përmbajtja e tij duhet të përcaktohet rast pas rasti".³⁵

Dispozitat ligjore evropiane:

- Sigurimi i interesit më të lartë është konsiderata kryesore në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga direktivat.

Udhëzim: Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i CRC-së thekson se "duhet të respektohet e drejta e fëmijëve që interesi e tyre më i lartë të jetë konsiderata kryesore në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta, sidomos kur ata janë viktime të dhunës, si dhe në të gjitha masat e parandalimit". Komenti i Përgjithshëm nr. 14 i CRC-së e vë theksin te ekipet shumëdisiplinore në vlerësimin dhe përcaktimin³⁶e interesit më të lartë të fëmijës (KP nr. 14, paragrafi 47). Duke punuar së bashku, një ekip shumëdisiplinor dhe ndërishtitucional është në pozitën më të mirë për të bërë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe për të marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës gjatë gjithë procesit. Rutina dhe masat e zakonshme ndihmojnë për t'u siguruar

³⁵ Ndërhyrjet e fundit në teorinë dhe praktikën e interesit më të lartë të fëmijës mund të gjenden në këtë përmbledhje të eseve: The best interests of the child – A dialogue between theory and practice (Council of Europe, March 2016) <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680657e56>

³⁶ Vlerësimi i referohet vlerësimit dhe baraspeshimit të të gjithë elementëve të nevojshëm për të marrë një vendim në një situatë specifike. Përcaktimi i referohet procesit formal të hartuar për të përcaktuar interesin më të lartë të fëmijës bazuar në vlerësimin e interesit më të lartë (Komenti i Përgjithshëm nr. 14, paragrafi 47, i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës)

që interesi më i lartë i fëmijës të jetë në qendër të procesit shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional.

Shih gjithashtu Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësi të përshtatur për fëmijët (2010) Kap. 3. D. Rekomandimet e KE-së për Shërbimet sociale përshtatura për fëmijët (2011) Kap. 3.A dhe dokumenti për reflekim i KE-së që propozon 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi po përmbushet

- Ekzistojnë dhe zbatohen në mënyrë sistematike korniza /praktika /procesi për angazhimin e ekipit shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës;
- Një listë (joshteruese dhe johierarkike) e elementeve që do të përfshihen në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës me qëllim që fëmija të gëzojë plotësisht dhe në mënyrë të efektshme të drejtat e tij, sipas parashikimeve në legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi, listë e cila përdoret sistematikisht nga ekipi në Barnahus;
- Personeli i ka të qarta rolet dhe përgjegjësitë përkatëse në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të çdo fëmije;
- Personeli është i vetëdijshëm dhe i trajnuar si të zbatojë procedurat dhe instrumentet për këtë qëllim, për shembull listkontrollet, protokollet dhe proceset për të vlerësuar dhe përcaktuar interesin më të lartë të çdo fëmije;

- Vlerësimi e interesit më të mirë merr në konsideratë mendimet dhe identitetin e fëmijës, ruajtjen e mjedisit familjar dhe të marrëdhënieve, kujdesin, mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës, situatën e cënueshmërisë, të drejtën për shëndet, arsim, ashtu si merr në konsideratë që elementët përkatës të jenë të baraspeshuar³⁷;
- Përcaktimi i interesit më të lartë kryhet nga profesionistë të kualifikuar pa vonesa të pajustificuara. Ai mbështetet në fakte të vërtetuara dhe në informacionet e dhëna nga fëmija dhe kujdestarët joabuzues.

Shembuj të instrumenteve që sigurojnë konsiderimin e qëndrueshëm dhe sistematik të interesit më të lartë të fëmijës

Praktikat dhe procedurat: praktikat dhe procedurat e qarta janë gurthemeli për të garantuar që konsiderata parësore në vendimet dhe ndërhyrjet që kryhen në Barnahus të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe se në çdo rast interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsideratë sistematike. Për shembull, ka procedura të qarta dhe agjendë të qëndrueshme për planifikimin e rregullt ndërinstitutional dhe konsultimet e përbashkëta që lidhen me vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës.

³⁷ Në Komentin e Përgjithshëm nr. 14, Komiteti identifikon disa situata ku është e domosdoshme të baraspeshohen elementet, edhe kur elementët e ndryshme të konsideruara në një rast të caktuar bien në kundërshtim (për shembull, ruajtja e mjedisit familjar kundër mbrojtjes së fëmijëve nga rreziku i dhunës nga prindërit).

Marrëveshjet ndërinstitucionale: marrëveshja zyrtare ndërinstitucionale bazë që do të shqyrtohet më tej në standardin 2, përcakton qartë angazhimet e institucioneve përkatëse, bashkë me rolet dhe përgjegjësitë. Kjo gjë ka provuar se ka qenë thelbësore për të siguruar që angazhimi i institucioneve dhe shërbimet e dhëna prej tyre të mos ndikohen nga ndryshimet në personel dhe në burime (të cilat mund të kenë ndikim negativ në vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e vlerësimit dhe përcaktimit të interesit më të lartë të fëmijës).

Listëkontrollet: Barnahus përdor listëkontrolle për t'u siguruar që interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsiderata parësore në vendimet dhe ndërhyrjet që ndërmerren për fëmijën si viktimë si dhe në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Vlerësimi: Barnahus ndërmerr një vlerësim periodik të procesit operativ, të procedurave specifike dhe të mjedisit të brendshëm në Barnahus nga këndvështrimi i fëmijës. Kjo ndihmon për të garantuar që procesi në tërësi, procedurat specifike dhe mjedisi të jenë të përshtatur për fëmijët dhe të ndjeshëm ndaj elementeve që janë thelbësore për të siguruar që interesi më i lartë i fëmijës të merret parasysh si përgjithësisht, ashtu edhe në rastet individuale.

Mbledhjet e kontrollit: Barnahus organizon mbledhje me fëmijën dhe kujdestarët e tij brenda një jave pas intervistës mjekoligjore në Barnahus. Këto mbledhje ofrojnë mundësinë për t'i marrë fëmijës dhe prindërve përshtypjet në lidhje me përvojën në Barnahus. Parashikohen edhe intervista telefonike me personin që e shoqëroi fëmijën në Barnahus, i cili mund të japë informacione për mënyrën si e përjetoi fëmija vizitën në Barnahus.

Korniza referuese për vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) ka dhënë udhëzime zyrtare për mënyrën si duhet të kryhet vlerësimi dhe përcaktimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe se cilat elemente duhen marrë parasysh në Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 14 (2013) për të drejtën e fëmijës që interesi e tij më i lartë të jetë konsideratë parësore (neni 3, paragrafi 1).

CRC shprehet se "vlerësimi i interesave më të mira të fëmijës është aktivitet unik që duhet të ndërmerret në çdo rast më vete, në dritën e rrethanave specifike të secilit fëmijë..." ku hyjnë "karakteristikat individuale të fëmijës si, ndër të tjera, mosha, gjinia, niveli i pjekurisë, përvoja, përkatësia në një grup pakicash, paaftësia fizike, ndijore ose intelektuale si dhe konteksti social dhe kulturor në të cilin ndodhen fëmija si të pasurit ose jo të prindërve, nëse fëmija jeton me ta, cilësia e marrëdhënieve midis fëmijës dhe familjes ose kujdestarëve të tij, siguria e mjedisit, ekzistenca e alternativave cilësore në dispozicion të familjes, familjes së zgjeruar ose kujdestarëve, etj".

Sipas CRC-së, përcaktimi se çfarë është në interesin më të lartë të fëmijës fillon me një vlerësim të rrethanave specifike që e bëjnë fëmijën unik. Ky proces mund të mbështetet duke hartuar një "listë joshteruese dhe johierarkike të elementeve që mund të përfshihen në vlerësimin të interesit më të lartë", listë që lidhet me kontekstin e Barnahus.

CRC-ja rekomandon që lista të japë udhëzime konkrete, por që të jetë aq elastike sa për të lejuar marrjen në konsideratë të faktorëve të tjerë që mund të jenë të rëndësishëm për çdo fëmijë. CRC-ja

nënvizon se "elementet që janë në kundërshtim me të drejtat e sanksionuara në Konventë ose që do të prodhonin efekte të kundërta me të drejtat e sanksionuara në Konventë nuk mund të konsiderohen të vlefshme në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës".

CRC-ja konsideron se kur vlerësohet dhe përcaktohet interesi më i lartë fëmijës duhet të merren parasysh elementet e mëposhtme. Elementet duhet të baraspeshohen me kujdes. Për një diskutim të hollësishëm rreth secilit prej këtyre elementeve shih Komentin e Përgjithshëm nr. 14, paragrafi 52 e vijues.

- Pikëpamjet e fëmijës
- Identiteti i fëmijës
- Ruajtja e mjedisit familjar dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve
- Kujdesi, mbrojtja dhe siguria e fëmijës
- Situata e cënueshmërisë
- E drejta e fëmijës për shëndet
- E drejta e fëmijës për arsim

Standardi 1.2 E drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë informacion

Cili është standardi?

E drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë informacion: e drejta e fëmijëve për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe për të marrë informacion respektohet dhe përmbushet.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Detyrimet ligjore ndërkombëtare: e drejta e fëmijëve për pjesëmarrje është një nga parimet e përgjithshme të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC). Artikulli 12, paragrafi 2, parashikon që fëmijës duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore dhe administrative që ka të bëjë me të.

Dispozitat ligjore evropiane:

- Marrja në konsideratën e duhur e pikëpamjeve të fëmijës
- Dhënia e informacionit
- E drejta për përkthim me gojë dhe me shkrim
- Mundësia për të urdhëruar që fëmija viktimë të dëgjohet duke përdorur teknologjitë e përshtatshme të komunikimit

Udhëzime: Komiteti i OKB për të Drejtat e Fëmijës (CRC) thekson se "mosha nuk duhet të pengojë të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë plotësisht në procesin e drejtësisë". E drejta për t'u dëgjuar e fëmijëve viktime të dhunës përcaktohet në nenin 19 të KDF-së dhe është ripohuar dhe sqaruar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, për shembull në Komentin e Përgjithshëm nr. 13. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës u ka kërkuar shteteve "të garantojnë që pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve viktime të abuzimit seksual ose krimeve të tjera të dhunshme të paraqiten dhe të konsiderohen në procedimet ku preken interesat e tyre personale". Duke bërë këtë, Shtetet "duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që e drejta për t'u dëgjuar të ushtrohet duke garantuar mbrojtjen e plotë të fëmijës" (Komenti i Përgjithshëm nr. 12 i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës). Masat duhet të zbatohen për të shmangur ritraumatizimin, për shembull duke shmangur përsëritjen e dëshmimeve dhe duke përdorur regjistrimin me video të intervistave (Dita e Përgjithshme e Diskutimit për të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar).

Shikoni gjithashtu Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatur për fëmijë (2010) Kap. IV.D.3; Rekomandimi i Këshillit të Evropës për Shërbimet sociale përshtatura për fëmijët (2011) Kap. 3. B dhe dokumenti për reflektim i KE-së që propozon 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë parimin 1.

Kërkimi dhe përvoja:e drejta për të marrë informacion dhe për t'u dëgjuar është aspekt themelor i procesit shumëdisiplinor dhe ndërinstucional. Të dëgjuarit sistematik të pikëpamjeve të fëmijës do të sigurojë një kuptim më të thellë të dëshirave dhe nevojave të fëmijës, do të lehtësojë përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës si dhe veprimet të përshtatshme e të qëndrueshme ku përfshihen, për shembull, trajtimi dhe terapia. Qasja në informacionin e duhur është parakusht për një pjesëmarrje kuptimplote. Kjo gjithashtu do të fuqizojë fëmijën dhe do ta ndihmojë fëmijën të fitojë kontroll mbi situatën.

Nëse fëmijëve u jepet mundësia për të dhënë përshtypjet mbi përvojën e tyre në shërbim, ata mund të kontribuojnë për t'i bërë mjediset, proceset dhe ndërhyrjet më të përshtatura për fëmijët dhe më të përshtatshme për nevojat dhe dëshirat e tyre.

Në një studim të kohëve të fundit të kryer nga Agjencia e të Drejtave Themelore, bazuar në intervistat me 392 fëmijë në 9 Shtete Anëtare të BE-së, fëmijët nënvizojnë rëndësinë e së drejtës së tyre për t'u dëgjuar me mirëkuptim dhe respekt. Aty theksohet nevoja për udhëzime të qarta dhe praktike si dhe për trajnime për të gjithë profesionistët që vihen në kontakt me fëmijët.³⁸

"Është gjë e bukur të dëgjohesh dhe të dish që ajo që thua do të sjellë ndryshimin"- një vajzë 16 vjeçare, viktimë e abuzimit seksual

³⁸ Drejtësia e përshtatur për fëmijë: Perspectives and experiences of children involved in judicial proceedings as victims, witnesses or parties in nine EU Member States (EU Fundamental Rights Agency, February 2017)
<http://fra.europa.eu/en/press-release/2017/child-friendly-justice-childs-perspective>

"Nuk kam marrë thujse (asnjë) informacion për këtë sepse prindërit e mi birësues e mbajnë gjithçka për vete"- vajzë 15 vjeçare, viktimë e abuzimit seksual³⁹

³⁹ Citim nga: Child-friendly justice: Perspectives and experiences of children involved in judicial proceedings as victims, witnesses or parties in nine EU Member States (EU Fundamental Rights Agency, February 2017) <http://fra.europa.eu/en/press-release/2017/child-friendly-justice-childs-perspective>

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi po përmbushet

- Personeli trajnohet si të komunikojë, të dëgjojë dhe të ndajë informacionin me fëmijët, të përshtatur për moshën dhe zhvillimin e tyre;
- Intervistat mjekoligjore kryhen në një mënyrë që ndihmon fëmijën të ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar në procedurat gjyqësore (shih gjithashtu Standardin 6 për intervistat mjekoligjore);
- Fëmijët dhe prindërit / kujdestarët e tyre joabuzues mund të ndikojnë në kohën, vendin dhe konfigurimin e ndërhyrjeve si trajtimi dhe terapia;
- Fëmijëve u jepet mundësia të japin përshtypjet e tyre për përvojën brenda shërbimit;
- Informacioni u vihet në dispozicion normalisht dhe sistematikisht fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre, i përshtatur për moshën dhe zhvillimin e fëmijës;
- Fëmijët dhe kujdestarët marrin informacion në gjuhën që kuptojnë;
- Bëhen përpjekje të veçanta për të garantuar që fëmijët me nevoja të veçanta ose aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi për të marrë informacion dhe për t'u dëgjuar.

Për të mësuar më shumë

Për të mësuar më shumë se si mund të zbatohen këto standarde sa i takon mbledhjes së mendimeve të fëmijëve për përvojën e tyre në Barnahus shih *Standardin 1.2. Instrumenti për Pjesëmarrjen e Fëmijëve*, i cili ofron orientime dhe një përzgjedhje të pyetësorëve tip.⁴⁰

Standardi 1.3 Shmangia e vonesave të pajustificuara

Cili është standardi?

Shmangia e vonesave të pajustificuara: merren masa që të shmangen vonesat e pajustificuara, duke siguruar që intervistat mjekoligjore, vlerësimet për mbrojtjen e fëmijës dhe për shëndetin mendor si dhe ekzaminimet mjekësore të ndodhin brenda një periudhe kohore të përcaktuar dhe që fëmijët të ta marrin informacionin në kohë.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Nuk ka vonesa të pajustificuara ndërmjet raportimit të fakteve dhe kryerjes së intervistave

⁴⁰ Lind Haldorsson, Olivia & Heiberg, Turid: Standard 1.2: Child Participation Tool (CBSS 2019)

- Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes
- Dhënia e informacionit
- Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) shprehet se ndihma efektive kërkon që veprimet, pasi të vendosen përmes një procesi pjesëmarrës, të mos i nënshtrohen vonesave të pajustificuara (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës). Shih gjithashtu Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë e përshtatur për fëmijët (2010), Kap. IV.D.4.

Kërkimi dhe përvoja:shmangia e vonesave të pajustificuara është një parim themelor i mbrojtjes së fëmijëve dhe i hetimeve dhe procedurave penale të përshtatura për fëmijët. Puna efektive ndërinstucionale varet edhe nga shmangia e vonesave të pajustificuara, në mënyrë që secili prej institucioneve të kryejë funksionet e veta në kohën e duhur. Kjo ka një ndikim pozitiv në mirëqenien e fëmijës dhe mund të përmirësojë rezultatet e hetimit penal dhe procesit gjyqësor. Për shembull, shmangia e vonesave të pajustificuara nga momenti i raportimit deri te intervista mjekoligjore mund të ndihmojë fëmijën të tregojë historinë e tij dhe të kujtojë detajet, duke përmirësuar kështu cilësinë dhe vlerën e dëshmisë së fëmijës. Mund edhe të ulë rrezikun që fëmija të ekspozohet ndaj presionit për të tërhequr dëshminë. Kjo gjë bën të mundur edhe vlerësimin e hershëm të nevojave të mundshme për mbrojtje pa prishur vlerën të dëshmisë së fëmijës si provë. Nga ana tjetër kështu garantohej eliminimi i vonesave në mbrojtjen e fëmijës nga ekspozimi i mëtejshëm ndaj dhunës. Një ekzaminim mjekësor i bërë në kohën e duhur mund të dokumentojë provat e dhunës fizike të cilat mund të orientojnë si proceset e trajtimit, ashtu dhe procedurat gjyqësore. Kjo gjë mund edhe të lejojë që shërbimet terapeutike të fillojnë më herët.

"Unë thjesht doja që gjithçka të mbaronte. Por po zgjaste pa fund dhe ne vazhdonim të kishim gjithnjë e më tepër vizita ku na thuhej se kjo punë do të zgjaste edhe më shumë... Doja që të mbaronte dhe unë t'i kthehesha jetës normale. Por u deshën muaj të tërë para se të ndodhte vërtet." - vajzë 12 vjeçare, viktimë e abuzimit seksual⁴¹

⁴¹ Citim nga: Child-friendly justice: Perspectives and experiences of children involved in judicial proceedings as victims, witnesses or parties in nine EU Member States (EU

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi po përmbushet

- Mblidhen të dhëna për të mbështetur monitorimin e afateve kohore në çështjet individuale dhe për të monitoruar performancën në shmangien e vonesave të pajustificuara;
- Konsultimet e përbashkëta për të përgatitur intervistën mjekoligjore zhvillohen sa më shpejt të jetë e mundur për të mos e vonuar intervistën;
- Prokurori që drejton hetimet paraprake vëzhgon intervistën mjekoligjore në një dhomë aty ngjitur në mënyrë që të mos ketë vonesa në qasjen te informacioni përkatës;
- Punonjësit socialë vëzhgojnë intervistën mjekoligjore në një dhomë aty ngjitur, në mënyrë që veprimet për të përmbushur nevojat e fëmijës dhe për ta mbrojtur të merren pa vonesë;
- Personeli në Barnahus qëndron i gatshëm gjatë intervistës mjekoligjore për t'u siguruar që të mund ndërhyjë menjëherë në rast krize, nëse lind nevoja;
- Direkt pas intervistës mjekoligjore zhvillohet një takim i përbashkët kontrolli për të siguruar që të gjithë i kanë të qarta hapat, rolet dhe përgjegjësitë e ardhshme;
- Gjatë takimeve ndër-institucionale të mbajtura para dhe pas intervistës mjekoligjore përdoren listëkontrollet për të siguruar që të mos humbasë asgjë dhe që të merren masat e duhura dhe të përshtatshme;

- Kryhet pa vonesë vlerësimi i nevojës për ekzaminim mjekësor. Nëse ekzaminimi mjekësor është i nevojshëm, ai zhvillohet në të njëjtën ditë me intervistën mjekoligjore në mjediset e Barnahus;
- Kryhet pa vonesë vlerësimi i nevojës për shërbime terapeutike, duke përfshirë mbështetjen në rast krize.

Treguesit sasiore

- Koha e kaluar midis zbulimit ose sinjalizimit të dyshimeve dhe fillimit të vlerësimit të nevojës për mbrojtje të fëmijës;
- Koha e kaluar midis zbulimit ose sinjalizimit të dyshimeve dhe takimit të parë ndërinstytucional të planifikimit;
- Koha e kaluar midis takimit ndërinstytucional të planifikimit dhe intervistës mjekoligjore;
- Koha e kaluar midis zbulimit ose sinjalizimit të dyshimit dhe intervistës mjekoligjore;
- Koha e kaluar midis zbulimit ose sinjalizimit të dyshimit dhe vlerësimit të shëndetit mendor;
- Koha e kaluar midis zbulimit ose sinjalizimit të dyshimit dhe ekzaminimit mjekësor;
- Koha e kaluar midis zbulimit ose sinjalizimit të dyshimit dhe ndërhyrjes mjekësore/ shëndetit mendor për fëmijën dhe familjen/ kujdestarët/personat e mbështetës joabuzues;
- Koha e kaluar midis fillimit të hetimeve penale paraprake dhe vendimit për ndjekje penale;
- Koha e kaluar midis fillimit të hetimit penal paraprak dhe procesit gjyqësor.

Standardi 2: bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe ndërinstitucional në Barnahus

Cili është standardi?

2.1 Statusi formal:Barnahus është trupëzuar formalisht në shërbimet kombëtare/vendore të mbrojtjes sociale/ mbrojtjes së fëmijëve, në organet e zbatimit të ligjit / sistemin gjyqësor ose në sistemin kombëtar shëndetësor. Barnahus mund të funksionojë si një shërbim i pavarur nëse gëzon rol statutor, të njohur nga autoritetet kombëtare/vendore, ku përfshihet mandati formal për të bashkëpunuar me institucionet publike përkatëse.

2.2 Organizimi i bashkëpunimit shumëdisiplinor dhe ndërinstitucional në Barnahus:bashkëpunimi është i strukturuar dhe transparent, me role, mandate, mekanizma bashkërendimi, buxhet, masa monitorimi dhe vlerësimi të përcaktuara qartë, të cilat kontribuojnë për procese të efektshme dhe sigurojnë vazhdimësi dhe qëndrueshmëri.

2.3 Procesi dhe praktika e bashkëpunimit shumëdisiplinor dhe ndërinstitucional në Barnahus:ndërhyrja shumëdisiplinore/ndërinstitucionale fillon me raportin fillestar dhe drejtohet nga një proces për ndërhyrjet bashkëpunuese gjatë gjithë vazhdimësisë së çështjes.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

Aspekti shumëdisiplinor/bashkërendimi/bashkëpunimi

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) nxit procedura efektive, përfshirë bashkërendimin ndërsektorial, të rregulluara nga protokollet dhe memorandumet e mirëkuptimit sipas nevojës (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës). Shih edhe Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësi të përshtatur për fëmijën (2010) Kap.IV.5; Rekomandimin e Këshillit të Evropës për Shërbime shoqërore të përshtatura për fëmijë (2011) Kap.V.E dhe dokumentin për refletim të Këshillit të Evropës që propozon 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve.

Kërkimi dhe përvoja: një organizatë e strukturuar, me role, mandate, mekanizma bashkërendimi, buxhet, masa monitorimin dhe vlerësim të përcaktuara qartë, kontribuon për t'i bërë efikase dhe bashkëpunuese ekipet ndërinstytucionale dhe mbështet respektimin e ndërsjellë të roleve dhe ndjenjën e përbashkët të përgjegjësisë. Marrëveshjet zyrtare ndihmojnë në sigurimin e vazhdimësisë dhe angazhimit nga drejtuesit e institucioneve përkatëse. Mbështetja e një anëtari të përhershëm të personelit, i caktuar për të bashkërenduar operacionet dhe ndërhyrjet e ekipit ndërinstytucional, mund të ndihmojë për të pasur procese dhe vazhdimësi pa pengesa. Koordinator mund të sigurohet që anëtarët e ekipit të ndjekin përgjegjësitë e tyre përkatëse dhe të zbulojë problemet në procesin shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional që në fazë të hershme. Për më tepër, koordinatori mund të luajë një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe respektimin e rutinave dhe procedurave.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi po përmbushet

Statusi formal

- Barnahus njihet dhe rregullohet nga shërbimet sociale ose shërbimet kombëtare/vendore të mbrojtjes së fëmijëve, nga forcat e policisë/sistemi gjyqësor ose sistemi kombëtar shëndetësor përmes ligjeve ose marrëveshjeve zyrtare;
- Barnahus ka një mandat formal nga autoritetet përkatëse për të bashkërenduar bashkëpunimin ndërinstytucional dhe për të ofruar shërbime shumëdisiplinore.

Marrëveshjet formale ndërinstytucionale bazë

- Një marrëveshje bazë ndërinstytucionale, e nënshkruar nga përfaqësues të autorizuar, angazhon organet përkatëse për bashkëpunim shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional dhe për ofrimin e shërbimeve në Barnahus;
- Marrëveshja bazë përfshin elementë të tillë si synimi, qëllimet, angazhimi, rolet dhe përgjegjësitë, organizimi, financat, privatësia, periudha kohore dhe menaxhimi i konflikteve;
- Marrëveshja formale bazë garanton që të gjitha agjencitë të kontribuojnë në kushte të barabarta në mënyrë që bashkëpunimi të trajtojë nteresin më të lartë të fëmijës në të gjitha aspektet, përfshirë shëndetin, mbrojtjen e fëmijës, aspektin ligjor dhe atë të shëndetit mendor;
- Marrëveshja formale bazë rishikohet dhe rifreskohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në legjislacion dhe në procedurat dhe strategjitë e institucioneve përkatëse;

- Zbatimi i marrëveshjes formale bazë mbikëqyret dhe drejtohet nga një komitet drejtues, i cili përfshin përfaqësues nga institucione të ndryshme;
- Personeli është në dijeni për marrëveshjen formale bazë dhe është trajnuar për zbatimin e saj.

Bashkërendimi

- Një apo më shumë punonjës kanë tagër të veprojnë si koordinatorë të Barnahus-it për bashkëpunimin ndërinstytucional;
- Roli i koordinatorit përcaktohet qartë në përshkrimin e vendit të punës;
- Grup ndërinstytucional i ndërlidhjes i Barnahus-it mblidhet rregullisht për të diskutuar aspektet praktike të bashkëpunimit të përditshëm ndërinstytucional, përfshirë rutinat dhe protokollet në Barnahus.

Buxheti

- Me marrëveshje formale, institucionet pjesëmarrëse angazhohen të kontribuojnë në buxhet për kostot operative dhe personelin e Barnahus-it.

Mbrojtja e fëmijëve dhe politika të tjera të brendshme

- Shërbimi ka politikë për mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizma raportimi, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të cilat mbulojnë katër standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve: Politikat, Njerëzit, Procedurat dhe Përgjegjësia;
- Personeli mbështetet dhe orientohet nga politika të brendshme të rëndësishme si politikat dhe procedurat për mbrojtjen e fëmijëve, kodi i sjelljes së personelit, politikat për

raportimin e parregullsisë, procedurat e sigurisë dhe një protokoll emergjence.

Rregullat për ngritjen dhe funksionimin e Barnahus në vendet nordike⁴²

Danimarkë

Në Danimarkë u miratua një ligj që e bëri të detyrueshëm ngritjen dhe përdorimin e Barnahus në nivel kombëtar para ngritjes së Barnahus:

“Këshillat bashkiakë në rajon do të ngrenë një shtëpi për fëmijë (Barnahus) në çdo rajon për të shqyrtuar rrethanat të miturit apo të riut që ka pësuar abuzime apo dyshohet se ka pësuar abuzime.

(2) Ministri për punët sociale dhe punët e brendshme mund të nxjerrë rregulla për strukturën, funksionimin, financimin dhe detyrat etj. të shtëpive për fëmijë”.⁴³

⁴² Kjo përmbledhje mbështetet në: Bakketeig, Elisiv (2016). Modeli Barnahus në vendet nordike. Punim i prezantuar në Konferencën rajonale dhe vizitën studimore të PROMISE, në Linköping 28-29 nëntor 2016. Bazuar në Johansson, Susanna, Kari Stefansen, Anna Kaldal & Elisiv Bakketeig (in press, 2017): Implementing the Nordic Barnahus model: Characteristics and local adaptations. In Johansson, S., Stefansen, K., Kaldal, A. & Bakketeig, E. (red.). Collaborating against child abuse: Exploring the Nordic Barnahus Model. London: Palgrave. Landberg, Åsa and Svedin, Carl Göran (2013). Inuti a Barnahus: A Quality Review of 23 Swedish Barnahus, Stockholm: Rädda Barnen. Informacioni i marrë nga Agjencia Qeveritare Islandeze për Mbrojtjen e Fëmijëve (Shkurt 2016).

⁴³ Akti i Konsolidimit për Shërbimet Sociale, §50 a.–(1), <http://english.sim.dk/media/14900/consolidation-act-on-social-services.pdf>

Përveç kësaj, Urdhri Danez për Barnahus-et rregullon funksionimin dhe karakteristikat kryesore për një Barnahus. Ka edhe standarde cilësie të hartuara nga Këshilli Kombëtar i Shërbimeve Sociale.

Islandë

Barnahus në Islandë u ngrit pa rregullim formal, bazuar në një marrëveshje jozyrtare ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse. Sot, Agjencia Qeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve (Barnaverndarstofa) ka detyrën të "administrojë qendra shërbimesh të veçanta me objektiv promovimin e bashkëpunimit ndërdisiplinor dhe forcimin e bashkërendimit midis institucioneve në trajtimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve"⁴⁴

Për më tepër, ligji i procedurës penale (nr. 88/2008) parashikon që viktimat që janë fëmijë deri në 15 vjeç do të pyeten nën kujdesin e një gjykatësi "në një strukturë të projektuar enkas për këtë qëllim"⁴⁵ dhe me ndihmën e një personi të trajnuar posaçërisht për këtë fushë⁴⁶. Këto dispozita të ligjit të procedurës penale përgjithësisht kuptohen nga gjykatësit se ata kanë detyrën për t'i intervistuar në Barnahus fëmijët nën 15 vjeç.

⁴⁴ Akti për Mbrojtjen e Fëmijëve, neni

7, https://eng.velferdarraduneyti.is/media/acrobat-en-skar_sidur/Child-Protection-Act-as-amended-2015.pdf

⁴⁵ Kodi i procedurës penale (nr. 88/2008), neni 9

⁴⁶ Straffeprosessloven (Kodi i Procedurës Penale), 239, 239 a-f., <http://www.lovdato.no/>

Norvegji

Barnahus në Norvegji në fillim u ngrit pa një kuadër rregullator formal. Sot, kodi i procedurës penale dhe rregullorja mbi intervistat hetimore të asistuar detyrojnë policinë dhe prokurorët që të përdorin Barnahus-in.⁴⁷

Suedi

Barnahus-et në Norvegji u ngritën pa një kuadër rregullator formal. Aktualisht nuk ka asnjë ligj që e kthen në detyrim përdorimin e Barnahus-eve. Megjithatë, Agjencia kombëtare e policisë, së bashku me Prokurorinë, Këshillin kombëtar të mjekësisë ligjore dhe Këshillin kombëtar të shëndetit dhe mbrojtjes sociale kanë miratuar udhëzimet dhe standardet kombëtare që duhen përbushur në mënyrë që veprimtaritë bashkëpunuese në mjedisë të përbashkëta të quhen Barnahus:

"Qëllimi i këtyre veprimtarive bashkëpunuese është të garantohet që fëmijëve që dyshohet se kanë qenë të ekspozuar ndaj krimit t'u sigurohet mbrojtje ligjore, trajtim dhe mbështetje e përshtatshme dhe, nëse është e nevojshme, ndërhyrje e menjëhershme terapeutike në rast krizash. Gjatë gjithë procesit, vëmendja duhet të interesit më i lartë i fëmijës. Fëmija duhet të informohet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të dhe duhet t'i jepet mundësia të shprehë pikëpamjet e veta sipas masës dhe mënyrës që ia lejon niveli i pjekurisë. Hetimet që kryhen paralel në kuadrin e sistemit ligjor dhe të shërbimeve sociale duhet të nisen menjëherë dhe duhet të

⁴⁷ Delredovisning av regeringsuppdrag avseende gemensamma nationella riktlinjer kring barn som misstänks vara utsatta för brott och kriterier för landets Barnahus (Rikspolisstyrelsen, Sweden, 2009)

zhvillohen me shpejtësinë që lejon vlerësimi i fëmijës dhe kompleksiteti i situatës. Hetimi paraprak duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe duhet të merret sa më shpejt një vendim për formalizimin e akuzave. Hetimet janë subjekt i afateve të parashikuara me ligj për përfundimin e tyre".⁴⁸

Detajet e bashkëpunimit ndërinstitucional në Barnahus rregullohen më së shumti me marrëveshje formale mes institucioneve (shih shembullin e Barnahus Linköping).

⁴⁸ <https://www.retsinformation.dk/Forms/R0710.aspx?id=158447>

Standardi 3: Grup i synuar

gjithëpërfshirës

Cili është standardi?

3.1 Përkufizim gjithëpërfshirës/i gjerë i grupit të synuar: grupi i synuar i Barnahus përfshin të gjithë fëmijët që janë viktime dhe/ose dëshmitarë krimesh që përfshijnë çdo formë dhune⁴⁹. Familjarët/kujdestarët joabuzues të fëmijës përfshihen si grup i synuar dytësor.

3.2 Mosdiskriminimi: bëhen përpjekje të veçanta për të arritur te të gjithë fëmijët që janë viktime dhe dëshmitarë, pavarësisht formës së dhunës.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Detyrimet ligjore ndërkombëtare dhe rajonale: mosdiskriminimi është një parim themelor i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (Neni 2 i KDF-së) dhe është thelbësor për zbatimin e Nenit 19 të KDF-së për të drejtën e fëmijës për të mos u dhunuar

⁴⁹ Dhuna përcaktohet këtu në përputhje me nenin 19 të KDF-së dhe Komentin e Përgjithshëm nr. 13 të CRC-së (2011): "të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, lëndimit dhe abuzimit, neglizhencës ose braktisjes, keqtrajtimin ose shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual".

Dispozitat ligjore evropiane:

- Mosdiskriminimi
- Dispozitat për identifikimin e viktimave, përfshi dispozitat specifike për identifikimin e fëmijëve viktimë të krimit, si p.sh. dispozitat për përcaktimin e moshës, të anëtarëve të familjes

Udhëzime: Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (CRC) thekson se Shtetet palë duhet të marrin masat e nevojshme për t’i siguruar çdo fëmije të drejtën për mbrojtje nga çdo formë dhune “pa asnjë lloj diskriminimi, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, bindjeve politike apo bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, pronave, aftësisë së kufizuar, statusit në lindje apo staturave të tjera të fëmijës ose prindit ose kujdestarit ligjor të fëmijës”. Për më tepër, Shtetet palë duhet të bëjnë përpjekje vetëvepruese për të siguruar që fëmijëve që ndodhen në situata potencialisht të pambrojtura t’u sigurohet e drejta për mbrojtje njësoj si gjithë fëmijëve të tjerë (Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 i CRC-së). Shiko gjithashtu Udhëzimet e Këshillit të Evropës për një drejtësi të përshtatur për fëmijët (2010) Kap.III.D dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës për shërbime sociale të përshtatura për fëmijët (2011) Kap.V.B

Kërkimi dhe përvoja: Barnahus mund të luajë rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrimeve të Shteteve palë duke përfshirë një grup të synuar të gjerë në misionin e tij dhe duke siguruar qasje dhe shërbime të barabarta për të gjithë fëmijët që referohen te këto shërbime.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi po përmbushet

Përcaktimi i grupit të synuar

- Grupet e synuara përcaktohen në shprehjen e misionit apo në marrëveshjen formale të themelimit të Barnahus;
- Grupet e synuara përfshijnë të gjithë fëmijët viktime apo dëshmitarë të çdo forme dhune, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm te abuzimi fizik dhe mendor, te dhuna në shtëpi, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për tregti, trafikimi, gjymtim i organeve gjinitale dhe krimi për arsye nderi⁵⁰.

Mosdiskriminimi

- Përgjigjja shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale u ofrohet të gjithë⁵¹ fëmijëve që orientohen te Barnahus. Në të gjitha rastet planifikohet dhe kryhet vlerësimi i mbrojtjes së

⁵⁰ Kur grupi i synuar përcaktohet në legjislacion ose udhëzime kombëtare, si për shembull në Danimarkë dhe Suedi, qasja duhet të paktën të garantohet për grupet e parashikuara nga ligji. Shërbimet duhet të synojnë përfshirjen e një grupi të gjerë të synuar, ku të përfshihen të gjitha format e dhunës. Megjithatë, shumë shërbime kanë filluar me një grup më të ngushtë, për shembull duke mbuluar vetëm abuzimin seksual dhe shfrytëzimin seksual dhe ngadalë kanë shkuar drejt mbulimit të formave të tjera të dhunës.

⁵¹ Arsytet e mundshme për diskriminim përfshijnë, pa kufizim, origjinën kombëtare ose etnike, racën, gjuhën, fenë, gjininë, orientimin seksual, situatën socioekonomike, aftësinë e kufizuar dhe statusin e refugjatit. Përpyqje të veçanta mund të jenë nevojiten për të arritur te fëmijët e pambrojtur.

fëmijës, hetimi penal, ekzaminimi mjekësor dhe mendor, ndërhyrja në raste krizash⁵² dhe kujdesi i vazhdueshëm;

- Fëmijët mund t'u qasen shërbimeve pavarësisht vendit se ku jetojnë. Sipas nevojës përdoren burimet e lëvizshme dhe sallat vendore për intervistat, veçanërisht për hetimet fillestare, ndërhyrjen dhe trajtimin e vazhdueshëm në raste krizash, dhe kujdesin e vazhdueshëm;
- Barnhaus është i disponueshëm për dhe i aksesueshëm nga fëmijët me nevoja dhe paaftësi të veçanta, në mënyrë që të marrin informacione, orientime dhe të kenë mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe për t'u shprehur në intervista;
- Kur është e nevojshme, fëmijëve dhe kujdestarëve joabuzues u ofrohet shërbimi i përkthimit, duke garantuar që ata të marrin informacione, orientime dhe mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe për t'u shprehur në intervista.

⁵² Lëvrimi i shërbimeve në Barnhaus mund të mos përfshijë sisa forma të ndërhyrjesh në rast krize, si për shembull kujdesi mjekësor në rast emergjence.

Standardi 4: Mjedis i përshtatur për fëmijët ⁵³

Cili është standardi?

4.1 Vendndodhja dhe lehtësia për t'iu afruar: mjediset e Barnahus preferohet të ndodhen në një ndërtesë më vete, e cila duhet të gjendet në një mjedis të njohur për fëmijët, për shembull në një zonë banimi. Mjediset duhet të jenë të arritshme me transport publik. Mjediset janë të arritshme edhe nga fëmijë me paaftësi dhe/ose me nevoja të veçanta.

4.2 Mjediset e brendshme: mobilet dhe materialet të përshtatura për fëmijët dhe me moshën e tyre, sidomos në dhomat e pritjes. Mjediset janë të sigurta fizikisht për fëmijët e të gjitha moshave dhe fazave zhvillimore, madje edhe për fëmijë me aftësi të kufizuar dhe/ose me nevoja të veçanta.

4.3 Privatësia: ekzistojnë mjedise të ndara, të izoluara nga ana akustike dhe private për të siguruar privatësinë.

4.4 Parandalimi i kontaktit me autorin e dyshuar të krimit: Barnahus është projektuar në mënyrë të tillë që kontakti mes viktimës dhe autorit të dyshuar të krimit të mund të shmanget gjatë gjithë kohës.

⁵³ E përshtatur për fëmijët këtu nënkupton vëmendjen ndaj nevojave specifike të fëmijëve, përshtatjen me to dhe ndjeshmërinë ndaj tyre.

4.5 Dhoma e intervistës: Barnahus siguron monitorim në kohë reale të intervistës nga ekipi ndërinstitucional, i cili qëndron në një dhomë tjetër⁵⁴.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Intervistat zhvillohen në ambiente të projektuara ose përshtatura për këtë qëllim
- E drejta për të shmangur kontaktet mes viktimës dhe autorit të krimit

Udhëzime: Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatur për fëmijën (2010) Kap. IV.D.5 dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës për shërbimet sociale të përshtatura për fëmijët (2011) Kap.IV.B.

Kërkimi dhe përvoja: vendndodhja dhe projektimi i ndërtesës janë thelbësore për t'u siguruar të gjithë fëmijëve qasje në shërbime dhe për të garantuar privatësinë dhe sigurinë e fëmijëve. Krijimi i një mjedisi të sigurt, neutral dhe të përshtatur për fëmijën është thelbësor në uljen e ankthit dhe parandalimin e (ri)traumatizimit. Një mjedis i përshtatur për fëmijën e ndihmon atë të hapet, gjë që është thelbësore për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës, për të përcaktuar nevojat për rikuperimin fizik dhe mendor dhe për të siguruar hetim penal dhe proces gjyqësor të suksesshëm.

⁵⁴ Familja /prindërit/kujdestarët nuk lejohen të vëzhgojnë intervistën me fëmijën.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Vendndodhja dhe lehtësia për t'iu afruar

- Barnahus ndodhet në një zonë të përshtatur për fëmijët, për shembull në një zonë banimi ose në një vend strategjik (p.sh. pranë një spitali);
- Transporti publik është aq afër me Barnahus sa mund të ecet në këmbë;
- Barnahus është i pajisur me rampë ose platformë ngritëse në hyrje.

Mjedis i brendshëm

- Fëmija mirëpritet nga një anëtar i personelit me sjellje miqësore dhe i ofrohet diçka për të pirë;
- Objektet në dhomën e pritjes, për shembull lodrat, revistat, librat dhe mobilet, u përshtaten fëmijëve të të gjitha moshave, fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me aftësi të kufizuara;
- Mjedis i brendshëm është i projektuar sipas udhëzimeve të praktikave më të mira për të siguruar lehtësinë e arritjes, për shembull ka vetëm një kat apo ashensor, korridoret mbahen të hapura dhe tualetet janë të arritshme;
- Kryhen rregullisht inspektime për sigurinë e mjedisëve.

Privatësia

- Ka dhoma të ndara pritjeje për raste kur është e nevojshme të mbrohet privatësia apo siguria e fëmijës ose nëse kërkohet nga agjencitë ligjzbatuese për ekzaminime ligjore;
- Të gjitha dhomat kanë izolim akustik;
- Vendndodhja dhe shenjat orientuese nuk bien në sy.

Parandalimi i kontaktit me të autorin e dyshuar të krimit⁵⁵

- Autorët e dyshuar të krimit merren në pyetje dhe u sigurohen shërbimet në një vendndodhje tjetër;
- Nëse autori i dyshuar i krimit hyn në të njëjtën ndërtesë, hyrjet dhe ambientet për fëmijët dhe familjarët/kujdestarët joabuzues janë të ndryshme nga ato të autorëve të dyshuar të krimit;
- Takimet me fëmijët dhe me autorët e dyshuar të krimit planifikohen në mënyrë të tillë që të shmangët kontakti.

Dhoma e intervistës

- Dhomat e intervistës dhe të vëzhgimit janë të ndara, por të lidhura me sisteme komunikimi të brendshme dhe sisteme audio-pamore;
- Intervista vëzhgohet përmes një ekрани në dhomën e vëzhgimit ngjitur;
- Dhoma është e rehatshme dhe e përshtatur për fëmijët. Është mobiluar dhe zbukuruar në mënyrë të tillë që të shmangët shpërqëndrimi;
- Kamera është e fokusuar në mënyrë të tillë që mund të ndjekë fëmijën dhe të kapë lëvizjet e dorës nëse fëmija vizaton ose tregon diçka.

⁵⁵ Në disa raste, takimet terapeutike që përfshijnë autorin e veprës penale dhe fëmijën mund të mbahen në mjediset e shërbimit, nëse vlerësohet se është në interesin më të lartë të fëmijës. Konsideratat kryesore janë siguria dhe mirëqenia e fëmijës. Në rastet e dhunës seksuale dhe në rastet e rënda të formave të tjera të dhunës, autori i veprës penale nuk duhet të lejohet kurrë të hyjë në mjediset e Barnahus.

Standardi 5:

Menaxhimi ndërinstitucional i çështjeve⁵⁶

Cili është standardi?

5.1 Procedurat formale dhe praktikat e zakonshme: shqyrtimi dhe planifikimi ndërinstitucional i çështjeve janë pjesë përbërëse e punës së skuadrës së Barnahus dhe e institucioneve përkatëse në Barnahus dhe formalizohen me procedura dhe praktika të përbashkëta të dakordësuara.

5.2 Planifikimi dhe shqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve: në Barnahus zhvillohen rregullisht takime për shqyrtimin dhe planifikimin e çështjeve, me pjesëmarrjen e institucioneve përkatëse në ekipin ndërinstitucional.

⁵⁶ Planifikimi ndërinstitucional, verifikimi i çështjeve dhe ndjekja e tyre mund të marrin formë sipas kufizimeve për shkëmbimin e informacionit në legjislacionin kombëtar ose sipas mungesës së legjislacionit që mundëson dhe lejon shërbimet të shkëmbejnë informacionet specifike të çështjeve. Niveli i lartë i integritetit kërkon qasje të qartë dhe të kujdeshme ndaj detyrimeve për fshehtësinë dhe mund të kërkojë një qasje hap pas hapi për të siguruar shkëmbimin e duhur të informacionit. Mund të jetë e nevojshme të gjenden zgjidhje, si protokollat ndërinstitucionale të mbrojtjes së të dhënave, për të trajtuar kufizimet ligjore dhe/ose rregullat që organizatat profesionale u imponojnë profesionistëve përkatës për shkëmbimin e informacioneve specifike të çështjeve që trajtojnë.

5.3 Ndjeka e vazhdueshme e çështjeve: duke respektuar ligjet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, privatësinë dhe fshehtësinë, Barnahus u siguron anëtarëve të ekipit ndërinstitucional dokumentacion dhe qasje të vazhdueshme në informacionin e rëndësishëm dhe në ecurinë e një çështjeje, deri sa ajo të zgjidhet.

5.4 Personi mbështetës⁵⁷: një individ i caktuar dhe i trajnuar apo anëtar i ekipit Barnahus monitoron reagimin shumëdisiplinor për të siguruar që fëmija dhe familja/kujdestarët joabuzues të kenë mbështetje dhe monitorim të vazhdueshëm.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Gjatë zbatimit të detyrimeve që burojnë nga Direktivat, vëmendja parësore është të sigurohet interesi më i lartë i fëmijës
- Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes
- Aspekti shumëdisiplinor/bashkërendimi/bashkëpunimi
- Dispozitat e Ciklit të Besimit

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) thekson rëndësinë e procedurave efektive për zbatimin e të drejtës së fëmijëve për mbrojtje nga dhuna (Neni 19 i KDF-së), përfshirë bashkërendimin ndërsektorial i cili mandatohet sipas nevojës me protokolle dhe

⁵⁷ Ky rol zakonisht merret nga shërbimet sociale/shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve si administrues të çështjeve, kur ato janë të pranishme në Barnahus. Kur shërbimet sociale ose shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve nuk janë të pranishme, këtë rol mund ta marrë një anëtar i ekipit, i cili është personi ndërlidhës me shërbimet sociale ose ato të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor.

memorandume bashkëpunimi. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës gjithashtu deklaroi se "profesionistët që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve duhet të trajnohen për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe protokollet e bashkëpunimit". Procesi do të përmbajë: (a) një vlerësim pjesëmarrës e shumëdisiplinor të nevojave afatshkurtra dhe afatgjata të fëmijës, të kujdestarëve dhe familjes, i cili kërkon dhe i jep peshën e duhur pikëpamjeve të fëmijës si dhe atyre të kujdestarëve dhe familjes; (b) ndarja e rezultateve të vlerësimit me fëmijën, kujdestarët dhe familjen; (c) dërgimi i fëmijës dhe familjes të një sërë shërbimesh për të përmbushur nevojat e identifikuar dhe (d) verifikimi dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së ndërhyrjes. (Komenti i Përgjithshëm nr. 13). Shih gjithashtu Udhëzimet e KE-së për drejtësinë e përshtatur për fëmijët (2010) Kap. 4.A.5 dhe Rekomandimi i KE-së për Shërbimet sociale përshtatura për fëmijët (2011) Kap. VE, Hd dhe J.

Kërkimi dhe përvoja: Planifikimi i çështjeve ndërinstitucionale i mbështetur në procedura dhe protokolle është i rëndësishëm për të garantuar ndërhyrje shumëdisiplinore, të bashkërenduara, efikase dhe të përshtatshme nga ekipi ndërinstitucional dhe organet përkatëse. Rishikimi dhe monitorimi i mundësojnë ekipit të mbledhin dhe shkëmbejnë informacione në mënyrë që rastet specifike të mund të konsultohen dhe rishikohen në të gjitha fazat e hetimit dhe procesit gjyqësor, sa më shumë të jetë e mundur dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe interesin më të lartë të fëmijës. Për më tepër, mbajtja e çështjeve nën kontroll i mundëson ekipit ndërinstitucional të monitorojë ecurinë dhe rezultatet e çështjeve që i janë referuar shërbimit. Mbështetja e duhur e viktimës dhe ndjekja nga profesionistët të përcaktuar gjatë gjithë procesit mund të ndihmojë në uljen e ankthit dhe traumës së fëmijës dhe familjes / kujdestarëve joabuzues. Aspekt thelbësor i mbështetjes së viktimave është të

garantohet që të ketë informacion të vazhdueshëm për fëmijën dhe kujdestarët jobuzues dhe që pikëpamjeve të fëmijës t'u jepet vëmendja e duhur. Familjet dhe kujdestarët joabuzues mund të kenë nevojë për orientim dhe mbështetje për rritjen e kapacitetit të tyre për të mbështetur fëmijën, për të kuptuar procesin gjyqësor, të drejtat e fëmijës dhe trajtimet e disponueshme.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Procedurat dhe praktikat formale

- Barnahus ka procedura formale për menaxhimin e çështjeve si dhe për planifikimin e takimeve, dokumentacionin dhe ndjekjen;
- Ka një protokoll që mbështet ekipin ndërinstitucional për t'u marrë me mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave;
- Ekziston një sistem për të vlerësuar ndikimin e përgjigjes shumëdisiplinore të fëmija;
- Verifikimi dhe planifikimi i çështjeve bashkërendohet dhe lehtësohet nga një anëtar i caktuar i personelit të Barnahus;
- Personeli është i informuar dhe trajnuar për procedurat dhe praktikat.

Planifikimi ndërinstitucional dhe verifikimi i çështjeve

- Organizohet një takim fillestar me të gjitha institucionet përkatëse për të planifikuar dhe bashkërenduar përgjigjen shumëdisiplinore;
- Pas intervistës mjekoligjore dhe ekzaminimit mjekësor mbahet një takim vijimësie me të gjithë profesionistët përkatës për të shkëmbyer konstatimet dhe për të planifikuar dhe bashkërenduar ndërhyrjet në vazhdimësi;

- Mbahen takime të rregullta midis institucioneve përkatëse për të shqyrtuar çështjet, shkëmbyer informacione të përditësuara dhe për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjes shumëdisiplinore dhe ndërinstytucionale;
- Verifikimi i çështjeve përfshin të gjitha institucionet në mënyrë të barabartë dhe asnjë institucion nuk mbizotëron në kurriz të disiplinave të tjera;
- Në rastet kur fëmija ka aftësi të kufizuara në nxënie ose nevoja të veçanta, u merret mendimi profesionistëve me ekspertizë, mundësisht atyre që e njohin paraprakisht fëmijën në fjalë, për planifikimin e të gjitha shërbimeve ku përfshihen intervista mjekoligjore, ekzaminimi mjekësor dhe terapia.

Mbajtja nën kontroll e çështjeve

- Barnahus dokumenton sistematikisht informacionin specifik të çështjes, gjithmonë duke respektuar legjislacionin dhe politikat kombëtare për mbrojtjen e të dhënave, të privatësisë dhe të konfidencialitetit. Informacioni i mbledhur përfshin, por jo vetëm: të dhënat demografike të viktimës dhe familjes, intervistat mjekoligjore dhe pjesëmarrjen në intervista mjekoligjore, numrin e takimeve shumëdisiplinore të mbajtura për verifikimin e çështjeve, përfaqësimin e institucionit në këto takime, raportet terapeutike dhe raportet mjekësore aty kur është e mundur.⁵⁸

⁵⁸ Shërbimet sociale ose shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve zakonisht mbledhin të gjitha informacionet që lidhen me rastin, përfshirë raportet mjekësore, raportet e policisë dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës. Të gjitha institucioneve u kërkohet t'u japin informacion shërbimeve sociale dhe atyre të mbrojtjes së fëmijëve.

Personi mbështetës

- Fëmijës dhe kujdestarëve u ofrohet mbështetje e vazhdueshme dhe informacion i rregullt gjatë gjithë procesit hetimor dhe gjyqësor;
- Ndjekja pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe trajtimit organizohet në përputhje me nevojat e fëmijës dhe familjes/kujdestarëve⁵⁹;
- Një individ i caktuar dhe i trajnuar ose anëtar i ekipit ndërinstitucional monitoron përgjigjen shumëdisiplinore për të siguruar që fëmija dhe familja / kujdestarët joabuzues të kenë mbështetje dhe ndjekje të vazhdueshme;
- Nëse rolin e personit mbështetës / koordinatorit e kryen një nga autoritetet që nuk është i pranishëm në shërbim, atëherë përgjegjës për lidhjen me këtë autoritet është një anëtar i ekipit të shërbimit, për të siguruar komunikimin dhe ndjekjen e duhur.

Rregullimi i shkëmbimit të informacionit në Barnahus sipas legjislacionit danez

Gjatë shqyrtimit të një rasti ku përdoret shtëpia për fëmijë, cf. seksioni 50a, personeli i shtëpisë për fëmijë, policia dhe prokuroria, autoritetet shëndetësore, profesionistët e autorizuar të kujdesit shëndetësor dhe autoritetet bashkiake që merren me fëmijët dhe të rinjtë në situatë

⁵⁹ Ndjekja në vijimësi, mbështetja dhe ndihma e vazhdueshme zakonisht sigurohet nga shërbimet sociale dhe shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor. Kur shërbimet sociale dhe atë të mbrojtjes së fëmijëve janë të pranishme në Barnahus, ato veprojnë si administrues të çështjeve dhe sigurojnë bashkërendimin dhe vijimësinë e përgjithshme. Menaxheri i çështjes gjithashtu monitoron zbatimin e parimeve kryesore dhe respektimin e të drejtave të fëmijës gjatë procesit.

shoqërore të pafavorshme mund të shkëmbejnë informacion të ndërsjellë edhe për aspekte tepër private të rrethanave personale dhe familjare të fëmijës ose të riut, nëse një shkëmbim i tillë informacioni duhet të konsiderohet i nevojshëm në funksion të shëndetit dhe zhvillimit të fëmijës ose të riut. 50.1 (c) Ligji i Konsoliduar për Shërbimet Sociale

Rolet dhe funksionet e institucioneve përkatëse në takimin ndërinstitucional - Barnahus Linköping

Barnahus

Kryeson takimin ndërinstitucional. Është përgjegjës për të garantuar që në mbledhje të bëhet një vlerësim i përbashkët bazuar në informacionin nga institucionet përkatëse. Është përgjegjës për arritjen e një marrëveshjeje midis institucioneve për planifikimin e vazhdueshëm të çështjeve. Shërben si sekretar i Grupit drejtues dhe shpërndan procesverbalin e takimit te institucionet pjesëmarrëse.

Njësia Pediatrike në spital

Kontribuon me ekspertizë mjekësore. Bën një vlerësim fillestar të nevojave për ekzaminim mjekësor. Jep informacion rreth të dhënave të mëparshme që mund të ketë për fëmijën.

Agjencia për psikiatrinë e fëmijëve dhe adoleshentëve

Kontribuon me ekspertizë psikiatrike për fëmijë. Bën vlerësimin fillestar të rastit për përcaktimin e nevojës për mbështetje në rast krize dhe ndërhyrje terapeutike. Jep informacion rreth të dhënave të mëparshme që mund të ketë për fëmijën.

Policia dhe prokuroria

Kontribuojnë me ekspertizë penale dhe gjyqësore. Bëjnë vlerësim fillestar të nevojës për të filluar një hetim penal.

Shërbimet sociale

Kontribuojnë me ekspertizë psikosociale. Bëjnë vlerësimin fillestar të rastit për problematika lidhur me mbrojtjen e fëmijës dhe për ndërhyrje. Jep informacion rreth të dhënave të mëparshme që mund të ketë për fëmijën.

Rendi i përhershëm i ditës për takimin ndërinstytucional në Barnahus - Stokholm

Hyrje dhe struktura e takimit

- Prezantimi i pjesëmarrësve: emri dhe institucioni
- Dokumentimi i takimit: shënime të përbashkëta nga takimi ose secili institucion veç e veç
- Aspektet e ruajtjes së fshehtësisë: a ka detyrime për fshehtësi informacioni ndonjëri prej institucioneve - informacion i shkurtër

Qëllimi i takimit

- Shkëmbimi i informacionit dhe planifikimi i përbashkët
- Të garantohet që perspektiva dhe interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsideratë parësore
- Të përcaktohet qëllimi specifik për çështjen

Historiku dhe njohuritë e mëparshme rreth çështjes

- Shërbimet sociale: hetime të mëparshme në lidhje me dhunën në familje - kur janë kryer

- Ndërhyrjet e mëparshme dhe rezultatet
- Policia / Prokuroria: A ka raporte të mëparshme nga policia për ndonjë pjesëtar të familjes, për shembull për dhunë, abuzim me drogë ose krime të tjera të rënda?
- Verifikimi i ditareve të mundshëm nga çështjet e ekipit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të Agjencisë për Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoleshentëve

Planifikimi paraprak i intervistës mjekoligjore

- Çfarë veprimi kanë kryer institucionet përkatëse që nga koha kur është bërë raporti i policisë?

Planifikimi për ditën e intervistës mjekoligjore:

- Data dhe ora
- Përfaqësuesi ligjor dhe personi i afërt me fëmijën, i cili do ta shoqërojë atë në Barnahus
- Karakteristikat dhe situata specifike e fëmijës si gjuha, nevojat e veçanta, situata në shtëpi
- Prania e Agjencisë për Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoleshentëve në dhomën e vëzhgimit

Planifikimi pas intervistës mjekoligjore - elementet që duhen marrë në konsideratë

- Vlerësimi i mbrojtjes së fëmijës - skenarë të ndryshëm
- Si do të informohet kujdestari i fëmijës?
- Planifikimi i ribashkimit të mundshëm të fëmijës me prindërit / kujdestarët pas intervistës
- Mendimet e prokurorit dhe të policisë për hapat e mëtejshëm
- Ndërhyrja në rast krize
- Ekzaminimi mjekësor

- Kush do t'i sigurojë fëmijës informacion në lidhje me vendimet dhe veprimet - Neni 12 i KDF-së

Çështje të tjera

- A ka vëllezër e motra që mund të kenë qenë dëshmitarë të dhunës?
- Të tjera, përfshirë nevojën e mundshme për përkthim

Përmbledhja e takimit ndërinstitucional

- Përmbledhja e takimit
- Nëse kërkohen ndryshime në planifikim, duhet të informohen të gjitha institucionet

Standardi 6: Intervistat mjekoligjore⁶⁰

Cili është standardi?

6.1 Praktika dhe protokollet e bazuara në prova: intervistat mjekoligjore kryhen sipas praktikës dhe protokolleve të bazuara në prova, të cilat sigurojnë cilësinë dhe sasinë e provave të marra. Qëllimi kryesor i intervistës është të shmangë (ri) traumatizimin dhe të nxjerrë dëshminë e lirë dhe sa më të detajuar të fëmijës, në respekt të normave për elementet provues dhe të drejtat për t'u mbrojtur.

6.2 Personel i specializuar: intervistat mjekoligjore kryhen nga personel i specializuar që trajnohet rregullisht për kryerjen e intervistave mjekoligjore.

6.3 Vendndodhja dhe regjistrimi: intervistat mjekoligjore bëhen në Barnahus. Intervistat regjistrohen me video në mënyrë që të

⁶⁰ Intervista mjekoligjore mund të përkufizohet si "intervistë e kryer në një seancë e vetme dhe e regjistruar, e menduar për të nxjerrë informacionin unik të fëmijës kur ka shqetësime për abuzim të mundshëm ose kur fëmija qenë dëshmitar i dhunës ndaj një personi tjetër"<http://www.nationalcac.org/forensic-interview-services>) ose "një bisedë e strukturuar me një fëmijë që ka për synim të nxjerrë informacion të detajuar në lidhje me një ngjarje të mundshme që fëmija mund të ketë përjetuar ose për të cilën është dëshmitar".
(http://www.smallvoices.org/what_we_do/forensic_interviews.html). Intervista mjekoligjore mbledh nga fëmija informacione që kanë të bëjnë me procesin gjyqësor ose që janë të përshtatshme për të.

shmangen intervistat e përsëritura nga profesionistë të ndryshëm që kërkojnë të dëgjojnë dëshminë e fëmijës.

6.4 Prania shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale: intervista mjekoligjore kryhet nga një profesionist i vetëm. Të gjithë anëtarët e ekipit shumëdisiplinor dhe ndërinstucional që merren me çështjen mund të vëzhgojnë intervistën mjekoligjore, mund të qëndrojnë në dhomën ngjitur ose mund ta shohin nga regjistrimi. Ka sistem ndërveprimi midis intervistuesit dhe vëzhguesve, në mënyrë që fëmijës t'i bëhen pyetje përmes intervistuesit.

6.5 Respektimi i të drejtës së të paditurit për një gjykim të drejtë dhe “barazia e armëve”: merren masat që t'i lejohe mbrojtjes t'i bëjë pyetje fëmijës viktimë / dëshmitar përmes intervistuesit mjekoligjor. Nëse personi i akuzuar ka të drejtën ligjore për të vëzhguar dëshminë e fëmijës, kjo bëhet përmes transmetimit audiovizual për të shmangur kontaktet e mundshme midis të akuzuarit dhe fëmijës.

6.6 Përshtatur për fëmijën: intervista është përshtatur për moshën, zhvillimin dhe sfondin kulturor të fëmijës dhe merr parasysh nevojat e veçanta, përfshirë përkthimin. Këtu mund të hyjnë edhe shkurtimi i kohëzgjatjes së intervistës, lejimi i pushimeve të shkurtra dhe mundësisht kryerja e intervistës në një seancë ose në disa seanca. Numri i intervistave kufizohet në minimumin e nevojshëm për hetimin penal. Nëse nevojiten disa intervista, ato kryhen nga i njëjti profesionist. Të gjitha masat merren në interesin më të lartë të fëmijës, që në disa raste mund të përfshijë kryerjen e më shumë intervistave dhe/ose ndryshimin e profesionistit që interviston fëmijën.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Dhënia e informacionit
- E drejta për përktim me gojë dhe me shkrim
- Procedura të përshtatura në hetime dhe procedura gjyqësore ku përfshihen fëmijë
- Aty ku është nevoja, intervistat kryhen në mjedise të krijuara enkas ose të përshtatura për zhvillimin e intervistave
- Intervistat kryhen nga profesionistë të trajnuar për këtë qëllim ose me ndërmjetësinë e tyre
- Nëse është e mundur dhe e përshtatshme, intervistat me fëmijët do t'i kryejnë të njëjtat persona
- Intervistat e viktimave të dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore ose dhunës në marrëdhënie të ngushtë kryhen nga persona të së njëjtës gjini me viktimën
- Numri i intervistave kufizohet sa të jetë e mundur. Ato kryhen vetëm kur është rreptësisht e nevojshme dhe në funksion të hetimeve dhe të procedimit penal
- Të gjitha intervistat me një fëmijë viktimë ose sipas rastit fëmijë dëshmitar, mund të regjistrohen në mënyrë audiovizuale. Këto regjistrime mund të përdoren si prova në proceset gjyqësore penale
- Mundësia për të urdhëruar që fëmija viktimë të dëgjohet duke përdorur teknologjitë e përshtatshme të komunikimit
- E drejta për të shmangur kontaktet mes viktimës dhe autorit të krimit
- Trajnime & instrumente
- Aspekti shumëdisiplinor/bashkërendimi/bashkëpunimi

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) thekson se "Hetimi i rasteve të dhunës, qofshin këto të denoncuara nga fëmija, një përfaqësues apo palë e tretë, duhet të ndërmerret nga profesionistë të kualifikuar të cilët janë trajnuar në mënyrë specifike dhe të plotë për këtë rol dhe kërkon qasje të bazuar në të drejtat e fëmijëve dhe të përshtatur për fëmijët. Procedurat hetimore të rrepta por të ndjeshme ndaj fëmijës do të ndihmojnë që dhuna të identifikohet saktë dhe do të ndihmojnë për të prodhuar prova për procedurat administrative, civile, të mbrojtjes së fëmijës dhe për procedurat penale. Duhet bërë jashtëzakonisht kujdes që fëmija të mos u nënshtrohet dëmeve të mëtejshme gjatë procesit hetimor. Për këtë qëllim, të gjitha palët janë të detyruara të kërkojnë dhe t'i japin peshën e duhur mendimeve të fëmijës." (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës). Për më tepër, CRC shprehet se kur shkelen të drejtat e fëmijëve "Shtetet duhet të kushtojnë vëmendje të veçantë për të garantuar se fëmijëve u vihen në dispozicion procedura të efektshme dhe të përshtatura për ta" (Komenti i Përgjithshëm nr. 5). Për më tepër, Shtetet palë nxiten "të miratojnë dhe zbatojnë rregulla dhe procedura për fëmijët viktime të dhunës fizike, abuzimit seksual ose krimeve të tjera të dhunshme duke garantuar që të shmangët përsëritja e dhënies së dëshmisë përmes përdorimit të intervistave të regjistruara me video për të ulur ritraumatizimin" (Dita e Përgjithshme e Diskutimit për të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar). Shih edhe Udhëzimet e KE-së për drejtësinë e përshtatur për fëmijët Kap. IV.D.6 dhe Dokumentin për reflektim të Komisionit Evropian që propozon 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve, Komisioni Evropian, për shembull Parimet 1, 2 dhe 6.

Kërkimi dhe përvoja: kërkimet kanë treguar që intervistat e përsëritura mund të jenë shumë traumatike për fëmijën dhe se ritraumatizimi mund të jetë akoma më i dëmshëm për fëmijën sesa vetë abuzimi. Prandaj, duhet të merren masa të veçanta për t'u siguruar që fëmijëve t'u jepet mundësia për ta dhënë dëshminë në një mjedis emocionalisht dhe fizikisht të sigurt dhe të favorshëm. Kërkimet kanë treguar gjithashtu se intervistat e përsëritura, të kryera nga njerëz që nuk janë të trajnuar posaçërisht për intervista mjekoligjore mund të shtrembërojnë rrëfimin e fëmijës për ngjarjet, për shembull duke përdorur pyetje sugjeruese. Intervistat mjekoligjore duhet të respektojnë kërkesat e rregullave për provat dhe të të drejtat për mbrojtje në mënyrë që provat e mbledhura të jenë të vlefshme në gjykatë.⁶¹

⁶¹ Kërkimi i përmendur këtu është i dokumentuar në disa botime, duke përfshirë, por pa u kufizuar te: Henry, Jim (1997). Following Disclosure, System Intervention Trauma to Child Sexual Abuse Victims. *Journal of Interpersonal Violence* 1997 12: 499; Newgent, Rebecca A., Fender-Scarr, Lisa K. and Bromley, Jamie L. (2002). The Retraumatization of Child Sexual Abuse: The Second Insult. *National Institute for Trauma and Loss in Children*, Volume 2, Number 2, Fall 2002; Newlin, Chris, Cordisco Steele, Linda, Chamberlin, Andra, Anderson, Jennifer, Kenniston, Julie, Russell, Amy, Stewart, Heather and Vaughan-Eden, Viola (2014). *Child Forensic Interviewing: Best Practices*. U.S. Department of Justice Office of Justice Programs Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention; Westcott Helen L. and Davies, Graham M (eds) (2002). *Children's Testimony: A Handbook of Psychological Research and Forensic Practice*. Wiley Series of the Psychology of Crime, Policing and Law, July 2002; Jansson, Helene, Rath-je, Pia and Gade Hansen, Søren (2015). The experience of children testifying in court in cases of sexual abuse. *Sexological Clinic at PCK Copenhagen, Center for Sexual Abuse, Rigshospitalet Copenhagen and the National Council for Children, Denmark*.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur⁶²

Praktika dhe protokolle të bazuara në prova

- Për të gjitha intervistat mjekoligjore dhe intervistat hulumtuese përdoren protokolle të bazuara në prova, të tilla si NICHD ose NCAC;
- Intervistuesit janë trajnuar për përdorimin e praktikave dhe protokolleve të bazuara në prova;
- Provat e mbledhura nga intervistuesit mjekoligjorë njihen vazhdimisht si të vlefshme nga gjykata.

Personel i specializuar

- Intervistat mjekoligjore dhe hulumtuese kryhen vetëm nga personel i specializuar;
- Personeli trajnohet rregullisht në kryerjen e intervistave mjekoligjore;
- Personeli merr rregullisht orientime, mbikëqyrje dhe këshillim, përfshirë edhe vlerësimin e kolegëve (shih standardin 9).

Vendi dhe regjistrimi

- Në Barnahus ka dhoma speciale për intervista mjekoligjore të përshtatura për fëmijët;

⁶² Të gjitha masat për t'iu përshtatur fëmijës duhet të marrin në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Në disa raste, kjo mund të nënkuptojë që treguesit e lidhur me numrin e intervistave dhe përdorimin e të njëjtit intervistues mund të mos jenë të zbatueshëm, sepse mund të jetë në interesin më të lartë të një fëmije të dhënë që t'i nënshtrohet intervistave të shumta ose që intervistat të kryhen nga persona të ndryshëm, nëse duhet të kryhen më shumë se një intervistë.

- Dhomat e intervistave janë të pajisura me kamera dhe sistem zëri, gjë që mundëson regjistrimin e intervistës mjekoligjore me cilësi të lartë dhe pamje të drejtpërdrejtë;
- Të gjitha intervistat janë të regjistruara me zë dhe figurë;
- Regjistrimet e intervistave ruhen në një vend të sigurt me qasje të kufizuar.

Prania shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale

- Si praktikë, intervistat kryhen nga një profesionist i vetëm, ndërsa profesionistët e tjerë që merren me çështjen vëzhgojnë nga një dhomë tjetër;
- Në një dhomë tjetër janë të disponueshme strukturat për të vëzhguar drejtpërdrejt intervistat në ekran;
- Strukturat u bëjnë të mundur vëzhgueseve të komunikojnë drejtpërdrejt me intervistuesin përmes kufjeve, nëse lind nevoja;
- Intervistuesit mjekoligjorë duhet të trajnohen si të përdorin shërbimin e përkthimit gjatë intervistës;
- Intervistuesi i shpjegon rolin e përkthyesit fëmijës dhe vetë përkthyesit. Intervistuesi rekomandon nëse përkthyesi duhet të jetë i lidhur përmes pajisjeve të telekomunikacionit ose nëse duhet të jetë i pranishëm në dhomën e intervistës dhe vendin ku duhet të qëndrojë. Përkthimi kontrollohet nga një përkthyes i dytë për të verifikuar saktësinë;
- Intervistat hulumtuese me fëmijë të pashoqëruar dhe azilkërkues vëzhgohen nga autoritetet përkatëse të imigracionit, nga kujdestari ligjor i fëmijës dhe nga profesionistët e tjerë kompetentë;
- Një listëkontrolli orienton ekipin vëzhgues dhe siguron që të gjithë të jenë të qartë për rolet dhe përgjegjësitë e tyre;

- Familjes dhe kujdestarëve joabuzues nuk u lejohe të vëzhgojnë intervistën mjekoligjore.

Përshtatur për fëmijë

- Numri i intervistave është i kufizuar në minimumin absolut të nevojshëm për hetimin penal;
- Nëse nevojiten disa intervista, ato kryhen nga i njëjti profesionit;
- Intervista i përshtatet situatës dhe karakteristikave të individit për nga moshë, zhvillimi, nga niveli gjuhësor, ai njohës dhe shoqëror, nga sfondi kulturor dhe gjendja emocionale;
- Nevojat e veçanta analizohen dhe plotësohen;
- Ofrohet përkthim nëse është i nevojshëm.

Respektimi i së drejtës së të paditurit për një gjykim të drejtë dhe për "mundësi të barabarta":

- Avokatit të mbrojtjes i ofrohet mundësia për të marrë në pyetje fëmijën pas dëshmisë së tij, për shembull duke e intervistuar fëmijën për herë të dytë;
- Nëse kërkohet një intervistë e dytë, ajo kufizohet në pyetje shtesë dhe nuk përmban përsëritjen e pyetjeve të intervistës së parë;
- Nëse kërkohet një intervistë e dytë, ajo kryhet nga i njëjti profesionist që zhvilloi intervistën e parë;
- I akuzuari nuk mund të hyjë në ambientet e Barnahus, por mund të lejohe të vëzhgojë intervistën përmes një transmetimi audiovizual.

"Ata presin që fëmijët t'u përgjigjen pyetjeve të pakëndshme dhe pyetjet i bëjnë me ton zyrtar. Kjo gjë i vë fëmijët në siklet dhe ua vështirëson përgjigjen" —vajzë 15 vjeçare, viktimë e abuzimit seksual

"Personat që kryejnë intervistat. Unë mendoj se ata janë më të rëndësishmit - ata duhet të jenë të qetë dhe miqësorë. Ky është element kryesor." —Djalë 16 vjeçar, viktimë e dhunës në familje

"Ata nuk duhet ta torturojnë fëmijën për ta treguar historinë kaq shumë herë... Është torturë e vërtetë. Për shembull, mund ta tregosh vetëm një herë, besoj... Drejtpërdrejt te psikologu i cili ia thotë hetuesit ose dikujt tjetër, pastaj ata duhet t'ia transferojnë atë gjyqtarit dhe fëmija nuk duhet të thirret më. Në rastin më të keq, fëmija duhet t'ia tregojë gjykatësit... Por jo në gjykatë." —vajzë 14 vjeçare, viktimë e abuzimit seksual

"Ishte e pakëndshme për mua të ritregoja disa herë atë që kishte ndodhur. Policëve, hetuesve, hetuesve paraprake mbase, nuk e di se çfarë ishin saktësisht. Por ishte e pakëndshme që m'u desh të ritregoja të njëjtën gjë më shumë se një herë." —djalë 16 vjeçar, viktimë dhe dëshmitar i abuzimit seksual⁶³

⁶³ Citim nga: Child-friendly justice: Perspectives and experiences of children involved in judicial proceedings as victims, witnesses or parties in nine EU Member States (EU Fundamental Rights Agency, February 2017) <http://fra.europa.eu/en/press-release/2017/child-friendly-justice-childs-perspective>

Standardi 7: Ekzaminimi mjekësor

Cili është standardi?

7.1 Vlerësimi: vlerësimet mjekësore dhe/ose vlerësimet mjekoligjore kryhen rregullisht brenda në Barnahus nga personeli i specializuar.⁶⁴

7.2 Trajtimi: trajtimi mjekësor kryhet brenda në Barnahus (nëse rastet urgjente ose të komplikua nuk kërkojnë ndërhyrje të veçanta në një mjedis spitalor, në regjim ambulator ose me shtrim).

7.3 Personeli: kontrolli mjekësor kryhet nga personel i specializuar i cili është trajnuar të dallojë treguesit e abuzimit fizik, seksual dhe emocional si dhe braktisjen e fëmijëve.

7.4 Rishikimi dhe planifikimi i çështjes: personeli mjekësor është i pranishëm në takimet e rishikimit dhe planifikimit sipas nevojës.

7.5 Informacioni dhe pjesëmarrja e fëmijës: fëmijët dhe familjarët/kujdestarët marrin informacionin e duhur për trajtimet e disponueshme dhe të nevojshme dhe mund të ndikojnë në kohën, vendin dhe konfigurimin e ndërhyrjeve.

⁶⁴ Ekzaminimi mjekoligjor mjekësor mund të përshkruhet si ekzaminim që kërkon të gjejë lëndime dhe të marrë mostra që mund të përdoren si prova në një hetim policor ose në gjykatë.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Marrja në konsideratën e duhur e pikëpamjeve të fëmijës
- Dhënia e informacionit
- E drejta për përkthim me gojë dhe me shkrim
- Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes
- Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes
- Përfshirja e profesionistëve të trajnuar në vlerësimin psikosocial, intervistën mjekoligjore dhe ekzaminimet fizike / Trajnimet dhe instrumentet
- Kontrollat mjekësore (ose mjekoligjore) ulen në minimum

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) ka theksuar se duhet të vihen në dispozicion të fëmijës, kujdestarëve dhe pjesëtarëve të tjerë joabuzues të familjes lloje të ndryshme mbështetjeje, përfshirë shërbimet mjekësore, ato të shëndetit mendor, shërbime sociale dhe ligjore. CRC-ja promovon gjithashtu ndërhyrje afatgjata dhe në vijimësi. Vendimi për mbështetjen e viktimës duhet të merret përmes një qasjeje pjesëmarrëse dhe duhen shmangur vonesat e pajustificuara. Duhet vëmendje e veçantë për të inkurajuar dhe për t'i dhënë peshën e duhur mendimeve të fëmijës (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i CRC-së). Për më tepër, CRC-ja thekson masat për të promovuar rikuperimin fizik dhe psikologjik të viktimave të dhunës, përfshirë shërbimet mjekësore (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i CRC-së). Shih gjithashtu Udhëzimet e KE-së për kujdesin shëndetësor të përshtatur për fëmijët (2011) Kap. IV.19

Kërkimi dhe përvoja: ekzaminimi mjekësor i çdo fëmije do të rrisë saktësinë e diagnostikimit në çdo rast të trajtuar. Forma të shumta abuzimi dhe braktisjeje ndonjëherë ndodhin në të njëjtën kohë, disa prej të cilave mund të humbasin lehtësisht pa një ekzaminim mjekësor.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Vlerësimi dhe trajtimi

- Ekzaminimi mjekësor, trajtimi dhe dërgimi i mundshëm të trajtimi mjekësor i specializuar është pjesë përbërëse e shërbimeve që ofron një Barnahus;
- Vlerësimet mjekësore dhe/ose vlerësimet mjekoligjore kryhen rregullisht në ambientet e Barnahus
- Trajtimi mjekësor kryhet në mjediset e Barnahus sipas rastit;
- Barnahus bashkërendohet me një spital lokal për dërgimin e rasteve përkatëse për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm, përfshirë rastet urgjente ose të komplikua që kërkojnë ndërhyrje të veçanta në një ambient spitalor, ambulator ose shtrim në spital si dhe me spitalet që i referojnë rastet të shërbimet në Barnahus.

Personeli

- Vlerësimi dhe trajtimi mjekësor në Barnahus kryhen nga një pediatër, gjinekolog, mjek i mjekësisë ligjore ose infermier i specializuar me trajnim të veçantë për abuzimin dhe braktisjen e fëmijëve në varësi të nevojave të fëmijës;
- Personeli është i aftë për dokumentimin fotografik të lëndimeve dhe dëmtimeve në trupin e viktimës;

- Personeli përdor dhe ka aftësinë të përdorë pajisje të përshtatura për fëmijët në ekzaminimin e përgjithshëm dhe të organeve gjenitale në Barnahus (p.sh. kolposkopi me video për ekzaminimin e abuzimit seksual dhe një kamera me cilësi të lartë për abuzimin fizik). Nëse nuk ka pajisje të tilla, fëmija dërgohet te një shërbim i cili mund të kryejë ekzaminimin pa vonesë.

Verifikimi dhe planifikimi i çështjes

- Personeli mjekësor është i pranishëm në forumin për verifikimin dhe planifikimin e rastit që bëhet gjatë vlerësimit fillestar dhe në takimet vijuese të verifikimit të rastit, sipas nevojës.

Informimi dhe pjesëmarrja e fëmijëve

- Fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre u sigurohet informacioni i duhur për ekzaminimin dhe trajtimin e disponueshëm;
- Barnahus nxit dhe i jep peshën e duhur mendimeve të fëmijës për ekzaminimin dhe trajtimin.

Standardi 8: Shërbimet terapeutike

Cili është standardi?

8.1 Vlerësimi dhe trajtimi ⁶⁵: vlerësimi dhe trajtimi u vihen vazhdimisht në dispozicion fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës që dërgohen në Barnahus.

8.2 Personeli: shërbimet dhe trajtimet për shëndetin mendor ofrohen nga profesionistë me formim dhe ekspertizë të specializuar.

8.3 Informacioni dhe pjesëmarrja e fëmijës fëmijët dhe familjarët/kujdestarët marrin informacionin e duhur në lidhje me trajtimet në dispozicion dhe mund të ndikojnë në kohën, vendin dhe konfigurimin e ndërhyrjeve.

8.4 Ndërhyrja në rast krize: Barnahus ka një strukturë të qartë organizative dhe personel të përhershëm për të ofruar rregullisht ndërhyrje mbështetëse në rast krize për fëmijën dhe anëtarët e familjes/kujdestarët joabuzues nëse është nevoja.

⁶⁵ Procesi i përcaktimit të nevojave dhe formulimi i një plani trajtimi mund të ndryshojë në varësi të specifikave të çështjes në fjalë.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Detyrimet ligjore ndërkombëtare dhe evropiane: Neni 39 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) kërkon që Shtetet Palë të marrin "të gjitha masat e nevojshme për të nxitur rimëkëmbjen fizike dhe psikologjike dhe riintegrimin shoqëror të çdo fëmije viktimë të çfarëdo forme të braktisjes, shfrytëzimit ose abuzimit [...].

Dispozitat ligjore evropiane:

- Marrja parasysh e mendimeve të fëmijës Dhënia e informacionit
- E drejta për përktim me gojë dhe me shkrim
- Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes
- Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes
- Përfshirja e profesionistëve të trajnuar në vlerësimin psikosocial, në intervistën mjekoligjore dhe ekzaminimet fizike / Trajtime dhe instrumente

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) ka theksuar se duhet të vihen në dispozicion të fëmijës, kujdestarëve dhe pjesëtarëve të tjerë joabuzues të familjes lloje të ndryshme mbështetjeje, përfshirë shërbimet mjekësore, ato të shëndetit mendor, shërbime sociale dhe ligjore. CRC-ja promovon gjithashtu ndërhyrje afatgjata dhe në vijimësi. Vendimi për mbështetjen e viktimave duhet të merret përmes një qasjeje pjesëmarrëse dhe nuk duhet të jetë subjekt vonesash të pajustificuara. Duhet vëmendje e veçantë për të inkurajuar dhe për t'i dhënë peshën e duhur mendimeve të fëmijës (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i CRC-së). CRC-ja ka ripohuar edhe se trajtimi "është një prej mjaft shërbimeve të

nevojshme "për të nxitur rikuperimin fizik dhe psikologjik të fëmijëve" që kanë përjetuar dhunë, madje edhe riintegrimin e tyre shoqëror. Sipas nenit 39 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, ky trajtim duhet të bëhet "në një mjedis që ushqen shëndetin, respektin për veten dhe dinjitetin e fëmijës". Duhet vëmendje e veçantë për të inkurajuar dhe për t'i dhënë peshën e duhur mendimeve të fëmijës. CRC-ja gjithashtu thekson se shërbimet duhet të përfshijnë familjet joabuzuese (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i CRC-së). Shih edhe Udhëzimin e KE-së për drejtësinë e përshtatur për fëmijët (2011) Kap. V.J.; Rekomandimin e KE-së për shërbimet sociale të përshtatura për fëmijët (2011) Kap. IV.B, V.E.1-3 dhe Dokumentin për reflektim të Komisionit Evropian i cili propozon 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve, Parimi 1 dhe 6.

Kërkimi dhe përvoja trajtimi efektiv për fëmijën dhe, nëse është e nevojshme për anëtarët e familjes/kujdestarët joabuzues, mund të ulë në minimum pasojat negative sociale, emocionale dhe pasojat e traumës në zhvillimin e fëmijës. Shmangia e vonësive të pajustificuara është thelbësore për të siguruar një trajtim efektiv. Fëmijëve dhe anëtarëve të familjes/kujdestarëve joabuzues që kanë nevojë për trajtim duhet t'u ofrohen shërbime terapeutike/të shëndetit mendor sa më shpejt të jetë e mundur.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Vlerësimi dhe trajtimi

- Vlerësimet e shëndetit mendor zakonisht kryhen në Barnahus bazuar në instrumente dhe pyetësorë të miratuar. Vlerësimet shërbejnë si bazë për zhvillimin e një plani trajtimi të bazuar në prova dhe në funksion të traumës;
- Trajtimi i përshtatet karakteristikave individuale të fëmijës si moshë, zhvillimi, niveli gjuhësor, njohës dhe social, nga sfondi kulturor dhe gjendja emocionale;
- Seanca e parë formale e terapisë fillon sa më shpejt të jetë e mundur *pas* intervistës mjekoligjore në mënyrë që të shmanget dëmtimi i rrëfimit të fëmijës. Nëse nevojiten ndërhyrje urgjente, ofrohet trajtim delikat nga pikëpamja mjekoligjore⁶⁶;
- Nëse është e nevojshme, fëmijëve u ofrohet trajtim afatshkurtër dhe afatgjatë. Nëse Barnahus nuk ofron trajtim afatgjatë, fëmija dërgohet në një shërbim tjetër terapeutik/të shëndetit mendor që ofron trajtim afatgjatë;
- Vlerësimi dhe trajtimi nuk varen kurrë nga vullneti i viktimës për të bashkëpunuar me hetimet, përndjekjen penale ose gjykimin.

⁶⁶ Kjo mund të ndodhë për shembull kur procedurat gjyqësore janë ende në kryerje e sipër dhe fëmija mund të jetë thirrur si dëshmitar, gjë që kërkohet në disa vende evropiane.

Personeli

- Anëtarët e personelit që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor kanë marrë formim të specializuar për vlerësimin dhe trajtimin e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të dhunës;
- Personelit i jepen vazhdimisht mundësi trajnimi, orientim, mbikëqyrje dhe këshillim.

Informimi dhe pjesëmarrja e fëmijëve

- Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve joabuzues u ofrohet rregullisht informacion për me trajtimet e disponueshme për ta;
- Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve joabuzues u ofrohen mundësi për të ndikuar në planin e trajtimit, madje edhe në kohën, vendndodhjen dhe konfigurimin e tij;
- Informacioni dhe trajtimi jepen në një gjuhë që fëmijët dhe familja/kujdestarët mund ta kuptojnë;
- Janë bërë përpjekje të veçanta për të siguruar që mbështetja e viktimës të plotësojë nevojat e veçanta të fëmijës dhe familjes/kujdestarëve, madje edhe nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Ndërhyrja në rast krize

- Në Barnahus ekziston një strukturë e qartë organizative dhe personel i përhershëm e i përgatitur për mbështetjen në rast krize;
- Mbështetja në rast krize në praktikë ofrohet në Barnahus për të gjithë fëmijët dhe anëtarët e familjes/kujdestarët joabuzues që kanë nevojë.

Standardi 9: Ngritja e kapaciteteve

Cili është standardi?

9.1 Trajnimi i profesionistëve: anëtarëve të personelit të Barnahus dhe të institucioneve të përfshira u ofrohet trajnim i rregullt në fushat e tyre specifike të ekspertizës si dhe trajnim i përbashkët për çështjet ndërsektoriale dhe bashkëpunimin ndërinstitutional.

9.2 Orientime, mbikëqyrje, këshillime: personeli i Barnahus-eve orientohet, mbikëqyret, këshillohet dhe vlerësohet nga kolegët rregullisht, si për rastet individuale, ashtu edhe për trajtimin e tensionit emocional profesional dhe personal dhe për trajtimin e sfidave dhe dilemave etike në punën me fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Intervistat kryhen nga profesionistë të trajnuar për këtë qëllim ose me ndërmjetësinë e tyre
- Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes
- Përfshirja e profesionistëve të trajnuar në kryerjen e vlerësimeve psikosociale, të intervistave mjekoligjore dhe të ekzaminimeve mjekësore/Trajnime & instrumente

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC) e vë theksin te masat arsimore me gamë të gjerë, përshirë një qasje te të drejtat e fëmijëve sipas Nenit 19 të KDF-së. Profesionistëve duhet t'u ofrohet "trajnim fillestar dhe në vendin e punës, i përgjithshëm dhe specifik për rolin e tyre (edhe ndërsektorial nëse është nevoja)". CRC-ja pohon se "profesionistët që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve duhet të trajnohen për bashkëpunimin ndërinstytucional dhe protokollet e bashkëpunimit" (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i CRC-së). Shih Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatur për fëmijët (2011); Rekomandimet e Këshillit të Evropës për Shërbimet Sociale të përshtatura për fëmijët (2011) dhe dokumentin për reflektim të KE-së që propozon 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve.

Kërkimi dhe përvoja: personeli i specializuar dhe trajnuar është nënvizuar si një nga treguesit kryesorë në mjaft prej standardeve të renditura në këtë dokument. Trajnimi dhe edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve të Barnahus është thelbësor për të pasur një personel të kualifikuar dhe një standard të lartë në shërbimet e ofruara. Trajnimi i përbashkët mund të ndihmojë punën bashkëpunuese të ekipit shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional, për shembull duke ndërtuar mirëkuptimin dhe konsensusin e përbashkët si dhe një kuptim më të mirë të roleve dhe përgjegjësisive të institucioneve përkatëse. Për të pasur sjellje profesionale, ndërhyrje me cilësi të lartë dhe për të mbrojtur ekipin nga mbilodhja fizike e mendore, është e domosdoshme që ekipit t'i ofrohen rregullisht udhëzime individuale dhe në grup, mbikëqyrje, këshillim si dhe vlerësim nga kolegët e tyre.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Trajnimi i profesionistëve

- Ekziston një plan i qartë për zhvillimin e aftësive dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit që punon me fëmijët në Barnahus⁶⁷;
- Ekipi i Barnahus ka plane individuale trajnimi të cilat zbatohen plotësisht dhe rishikohen rregullisht;
- Pjesëtarëve të ekipit ndërinstitucional u ofrohen rregullisht trajnime të përbashkëta dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të tyre, p.sh. rreth çështjeve ndërsektoriale dhe bashkëpunimit shumëdisiplinor.

Orientime, mbikëqyrje, këshillim

- Pjesëtarëve të ekipit të Barnahus u ofrohen orientime, mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale individuale dhe në grup;
- Pjesëtarëve të ekipit të Barnahus u ofrohet këshillim individual dhe në grup për raste specifike si dhe për të trajtuar tensionin emocional dhe profesional, sfidat dhe

⁶⁷ Trajnimi mund të përfshijë, pa kufizim: zhvillimin e fëmijës; të kuptuarit e fenomenit të abuzimit dhe braktisjes së fëmijëve; kryerjen e intervistave mjekoligjore; qasjen e përshtatur për fëmijët dhe të ndjeshme ndaj traumës në kryerjen e vlerësimeve klinike dhe mjekoligjore; sigurimin e formave të ndryshme të trajtimit të përqendruar te trauma dhe të bazuar në prova; të kuptuarit e kontekstit dhe kërkesave ligjore; identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe mbështetjen e familjeve në rrezik me qëllim parandalimin e ritraumatizimit; mbështetjen e prindërve joabuzues.

dilemat morale gjatë punës me fëmijë viktima dhe dëshmitarë të dhunës.

Standardi 10:

Parandalimi: Shpërndarja e informacionit, ndërgjegjësimi dhe ngritja e aftësive të jashtme

Cili është standardi?

10.1 Mbledhja e të dhënave, shpërndarja e informacionit dhe rritja e ndërgjegjësimit: Të dhënat/statistikat e bashkuara ose të ndara mblidhen dhe ndahen me palët e interesuara, me vendimmarrësit, botën akademike, specialistët e mbrojtjes së fëmijëve dhe publikun e gjerë për të rritur ndërgjegjësimin rreth dhunës ndaj fëmijëve dhe rolin e përgjigjeve shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale, për të ndihmuar kërkimet dhe për të mbështetur legjislacionin, politikat dhe procedurat e bazuara në prova shkencore.

10.2 Ngritja e aftësive të jashtme: Barnahus ofron veprime të synuara për të rritur aftësitë dhe njohuritë e profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët, për shembull duke organizuar vizita studimore, mbledhje informuese, leksione dhe duke prodhuar materiale të shkruara.

Pse duhet të përmbushet ky standard?

Dispozitat ligjore evropiane:

- Masa të domosdoshme për mbrojtjen e privatësisë, identitetit dhe imazhit të fëmijës viktimë dhe për parandalimin përhapjes së çdo lloj informacioni që mund të shpjerë në identifikimin e tij
- Trajnim dhe instrumente
- Të dhëna dhe monitorim
- Rritje ndërgjegjësimi
- Parandalimi

Udhëzime: Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës inkurajon diskutimin e hapur rreth dhunës ku përfshihet edhe angazhimi i medias dhe shoqërisë civile. Shtetet palë të KDF-së për më tepër duhet të krijojnë "një sistem gjithëpërfshirës dhe të besueshëm për mbledhjen e të dhënave kombëtare në mënyrë që të garantojnë monitorimin sistematik dhe analizën e sistemeve (analizat për ndikimin), shërbimeve, programeve dhe rezultateve". Shërbimet për të miturit viktimë dhe dëshmitarë të dhunës mund të japin kontribut të madh përmes mbledhjes së të dhënave. (Komenti i Përgjithshëm nr. 13 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës). Shih dokumentin për reflektim të Komunitetit Evropian ku propozohen 10 parime për sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë parimet 3, 5, 6, 9

Kërkimi dhe përvoja: puna ndërgjegjësuëse, e cila mund të përmbajë shpërndarjen e të dhënave të përgjithshme dhe specifike, të statistikave dhe informacionit për dhunën ndaj fëmijëve dhe të

ofrojë informacion për parandalimin dhe përgjigjen e duhur ndaj saj mund të shërbejë si një masë e rëndësishme parandalimi.

Ndërgjegjësimi dhe rritja e aftësive mund të ndihmojnë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së publikut, për rritjen e aftësive të profesionistëve dhe për rritjen e mbështetjes ndër vendimmarrësit dhe ligjvënësit për një përgjigje shumëdisiplinore dhe ndërinstucionale. Puna me median mund të jetë një instrument i rëndësishëm për të ndërgjegjësuar dhe informuar një audiencë më të gjerë. Gjatë gjithë punës me mediat, duhet të ketë garanci të mjaftueshme për të mbrojtur identitetin dhe interesat e fëmijës.

Shembuj treguesish dhe/ose provash që standardi është përmbushur

Mbrojtja e fëmijëve

- Merren masa për të mbrojtur fëmijët, privatësinë dhe të dhënat e tyre në kontekstin e gjithë punës ndërgjegjësuese, duke përfshirë ruajtjen e sigurt të të dhënave dhe qasjen e kufizuar në këto të dhëna;
- Aty ku përfshihen mediat ekzistojnë dhe zbatohen udhëzimet për etikën;
- Ekzistojnë dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme udhëzimet për përfshirjen e përshtatshme, të duhur dhe etike të Barnahus-it në rritjen e ndërgjegjësimit, në ngritjen e kompetencave dhe të kontributeve në fushata, studime, kërkime, dhe konsultime;
- Personeli i Barnahus është i informuar dhe është trajnuar për udhëzimet e lidhura me etikën.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i aftësive

- Barnahus organizon vizita studimore për profesionistët, vendimmarrësit, botën akademike dhe palët e tjera të interesuara;
- Barnahus ofron leksione, trajnime, seminare pune për profesionistë dhe studentë;
- Barnahus kontribuon në fushatat publike sipas rastit.

Mbledhja e të dhënave dhe kërkimet

- Është ngritur sistemi për të mbledhur të dhëna dhe përdoret sistematikisht për të mbledhur të dhënat e shpërndara;
- Barnahus kontribuon në kërkime, studime, sondazhe dhe konsultime, duke marrë parasysh me kujdes detyrimet etike.

Media

- Puna e medias, me synimin për të ndihmuar në parandalimin e dhunës dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, është një aspekt formal i funksionit dhe veçorive të këtij shërbimi në përshkrimet e vendit të punës së personelit të Barnahus;
- Personelit të Barnahus-it i jepet mundësia të trajnohet në fushën e medias.

Lidhja midis dispozitave, detyrimeve ligjore dhe Standardeve Evropiane për një Barnahus: pamje e përgjithshme

Tabela në faqet vijuese tregon marrëdhëniet midis Standardeve Evropiane për një Barnahus dhe detyrimeve kryesore ligjore të përcaktuara nga tre instrumente juridike evropiane: Konventa e Këshillit të Evropës, e vitit 2010, për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (Konventa e Lanzarotes), Direktiva e BE-së e 13 dhjetorit 2011 "Për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë" ("Direktiva për Abuzimin Seksual të Fëmijëve") dhe Direktiva e BE-së e 25 tetorit 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit ("Direktiva për të Drejtat e Viktimës").

Kolona e parë e tabelës (Standardi Barnahus) rendit Standardet Evropiane për një Barnahus.

Kolona e dytë (Detyrimi Ligjor Përkatës) tregon detyrimet ligjore më të rëndësishme për secilin standard. Detyrimet ligjore rrjedhin nga kuadri normativ i PROMISE. Ky kuadër u krijua në Përmbledhjen e

ligjeve dhe udhëzimeve nga PROMISE⁶⁸ për të përcaktuar detyrimet kryesore ndaj viktimave të krimit dhe përfshirjen e tyre në procedurat penale. Ky kuadër u përdor për të krijuar profilin e çdo ligji të rëndësishëm lidhur me këto detyrime kryesore.

⁶⁸ O'Donnell, Rebecca (2017) PROMISE Compendium of Law and Guidance: European and International Instruments concerning Child Victims and Witnesses of Violence, Stockholm, PROMISE Project Series

Kolona e tretë e tabelës (Instrumentet ligjore) tregon nenet specifike në të tre instrumenteve ligjore evropiane të specifikuara më sipër, të cilat lidhen me detyrimet përkatëse. Kjo kolonë gjithashtu i referohet deklamimeve të këtyre instrumenteve ligjore, të cilat ofrojnë udhëzime të rëndësishme për interpretimin e këtyre detyrimeve ligjore.

Për të mësuar më shumë

Teksti i plotë i deklamimeve dhe neneve të instrumenteve përkatëse ligjore mund të gjendet në versionin e plotë ⁶⁹ të këtij dokumenti ose në Përmbledhjen e ligjeve dhe udhëzimeve nga PROMISE⁷⁰.

⁶⁹ Lind Haldorsson, Olivia (2017) European Barnahus Quality Standards: Guidance for Multidisciplinary and Interagency Response to Child Victims and Witnesses of Violence www.barnahus.eu/standards

⁷⁰ O'Donnell, Rebecca (2017) PROMISE Compendium of Law and Guidance: European and International Instruments concerning Child Victims and Witnesses of Violence, Stockholm, PROMISE Project Series

STANDARDI BARNAHUS	DETYRIMI LIGJOR PËRKATËS	INSTRUMENT LIGJOR	KOMENT SHPJEGUES
<p>1.1 Interesi më i lartë i fëmijës</p>	<p>Gjatë zbatimit të detyrimeve që burojnë nga Direktivat, vëmendja parësore është të sigurohet interesi më i lartë i fëmijës</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 14, Neni 1.2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual të fëmijëve: Deklamimi 2, 6, 30, Neni 18.1</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 30.1</p>	<p>Referencat te deklamimet dhe nenet u referohen detyrimeve të përgjithshme për të siguruar interesin më të lartë të fëmijës. Shih standardin 1.2, 1.3, 4-10 për detyrimet specifike ligjore që lidhen me një praktikë të caktuar.</p>
<p>1.2. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë informacion</p>	<p>Marrja në konsideratën e duhur e pikëpamjeve të fëmijës</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 14, 42, Neni 1. 2; 10.1</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: 19.3</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 14.1,31.1</p>	<p>Shih edhe standardin 6, Intervistat mjekoligjore për të drejtën për t'u dëgjuar gjatë hetimeve penale. Shih edhe standardin 7 dhe 8.</p>
	<p>Dhënia e informacionit</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 21, 26, 30, 31, Neni 1.1.; 3; 4; 6</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 31.1 a, b, 31.2, 31.6</p>	<p>Shih edhe standardin 6, 7 dhe 8.</p>

Shënimet fundore

<p><i>vazhd. 1.2. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë informacion</i></p>	<p>E drejta për përkthim me gojë dhe me shkrim</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 34, 36, Neni 5.2-3; 7.1-7.8</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 31.6.</p>	<p>Shih edhe standardin 6 dhe 8. Neni 31.6 i Konventës së Lanzarotes përfshihet këtu për shkak se i referohet informacionit të dhënë në një gjuhë që fëmija mund të kuptojë.</p>
	<p>Mundësia për të urdhëruar që fëmija viktimë të dëgjohe duke përdorur teknologjitë e përshtatshme të komunikimit</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 23.3 (a) (b)</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.5 (b)</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 36.2 b</p>	<p>Shih edhe standardin 6.</p>
<p>1.3 Parandalimi i vonesave të pajustificuara</p>	<p>Nuk ka vonesa të pajustificuara ndërmjet raportimit të fakteve dhe kryerjes së intervistave</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 20. (a)</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3 (a)</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 30.3, Neni 35.1.a.</p>	<p>Referencat e deklamimeve dhe neneve përfshihen këtu kur ka referenca specifike që lidhen me parandalimin e vonesave të pajustificuara.</p>

Shënimet fundore

<i>vazhd. 1.3. Parandalimi i vonesave të pajustificuara</i>	Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 22.1	Shih edhe standardin 5, 7
	Dhënia e informacionit	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 4.1, 6.1 Konventa e Lanzarotss: Neni 31. 2	Shih edhe standardin 1.2
	Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes	Direktiva për abuzimin seksual të fëmijëve: Neni 18.2, 18.3	Shih edhe standardin 8
2. Bashkëpunim shumëdisiplinor dhe ndërinstytucional në Barnahus	Aspekti shumëdisiplinor/bashkërendimi/bashkëpunimi	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 38, 62, Neni 26. 1 Konventa e Lanzarotes: Neni 10.1, 10.3, 11.1	Shih edhe nenin 5.3 dhe 15 të Konventës së Lanzarotes për me masat parandaluese dhe nenin 38.1 a-c për bashkëpunimin ndërkombëtar.
3. Grupi i synuar	Mosdiskriminimi	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 9, 10, 15, 66, Neni 1; 22.3 Konventa e Lanzarotes: Neni 2	Deklamimet dhe nenet e përmendura këtu vendosin një detyrim të gjerë për të siguruar që të gjithë fëmijët të kenë qasje dhe të drejtë të barabartë të drejtësia dhe ndihma.

	Dispozitat për identifikimin e viktimave, përfshi dispozitat specifike për identifikimin e fëmijëve viktimë të krimit, si p.sh. dispozitat për përcaktimin e moshës, të anëtarëve të familjes	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 19, Neni 1; 2.1, 17, 24.2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 18.2, 18.3, 19.5</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 23 a, 11.2, 14.4, 34.2, 35.3</p>	Këto nene lidhen drejtpërdrejt me intervistat mjekoligjore, planifikimin ndërinstitucional dhe menaxhimin e çështjeve, ekzaminimin mjekësor dhe shërbimet terapeutike.
4. Mjedis i përshtatur për fëmijët	Intervistat zhvillohen në ambiente të projektuara ose përshtatura për këtë qëllim	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 9.1.; 9.3; 12. 1; 18; 22. 1; 22.4; 26</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 35.1.b</p>	Shih edhe standardin 6.
	E drejta për të shmangur kontaktet mes viktimës dhe autorit të krimit	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 19 1.-2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30</p>	Shih edhe nenin 31.1 të Konventës së Lanzarotes Shih edhe standardin 6.

<p>5. Menaxhimi i çështjeve në nivel ndërinstitucional</p>	<p>Gjatë zbatimit të detyrimeve që burojnë nga Direktivat, vëmendja parësore është të sigurohet interesi më i lartë i fëmijës</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 1 (c) 2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: 18.1, 19.2</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 30.1</p>	<p>Ekipi ndërinstitucional duhet ta ketë interesin më të lartë të fëmijës konsideratë bazë në të gjithë planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve.</p>
	<p>Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 9, 55, 56, 58, Neni 22.1-7</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: 19.3</p>	<p>Këto deklamime dhe nene i referohen rolit të ekipit ndërinstitucional në realizimin e vlerësimeve individuale dhe në zhvillimin e planeve.</p>
	<p>Aspekti shumëdisiplinor/bashkë rendimi/ bashkëpunimi</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Deklamimi 62, Neni 26. 1</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 10.1</p>	<p>Shih edhe nenin 38.1 a-c të Konventës së Lanzarotes për bashkëpunimin ndërkombëtar.</p>
<p><i>vazhd. 5. Menaxhimi i çështjeve në nivel ndërinstitucional</i></p>	<p>Dispozitat e Ciklit të Besimit</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 18</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30, Neni 19.1</p>	<p>Deklamimet dhe nenet i referohen rolit të ekipit ndërinstitucional për të garantuar se fëmijët janë të mbrojtur nga abuzimi i mëtejshëm.</p>

		Konventa e Lanzarotes: Neni 14.1	
6. Intervistat mjekoligjore	Dhënia e informacionit	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 21, 26, 30, 31, Neni 1.1.; 3.1-3; 4.1-2; 6 Konventa e Lanzarotes: Neni 31.1, 31.2	Shih edhe standardin 1.2
	E drejta për përkthim me gojë dhe me shkrim	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 9.1.; 9.3; 12. 1; 18; 22. 1; 22.4; 26 Konventa e Lanzarotes: 31.6	Shih edhe standardin 1.2. Neni 31.6 i Konventës së Lanzarotes përfshihet këtu për shkak se i referohet informacionit të dhënë në një gjuhë që fëmija mund të kuptojë.
<i>vazhd. 6. Intervistat mjekoligjore</i>	Procedura të përshtatura në hetime dhe procedura gjyqësore ku përfshihen fëmijë	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 58, 59, 66, Neni 1.1, 18, 23. 1. Konventa e Lanzarotes: Neni 30.1-4, 31.1	Shih edhe standardin 1.1-1.3. Standardi 1.3 përfshin detyrimin ligjor për të garantuar që të mos ketë asnjë vonesë të pajustificuar ndërmjet raportimit të fakteve dhe intervistave.
	Aty ku është nevoja, intervistat kryhen në mjedise të krijuara	Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Neni 23.2 (b)	Shih edhe standardin 4.

	enkas ose të përshtatura për zhvillimin e intervistave	Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3 Konventa e Lanzarotes: Neni 35.1 (b)	
	Intervistat kryhen nga profesionistë të trajnuar për këtë qëllim ose me ndërmjetësinë e tyre	Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Neni 23.2 (b) Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3 (c) Konventa e Lanzarotes: Neni 35.1 (c)	Shih edhe Trajnimin dhe instrumentet këtu më poshtë.
	Nëse është e mundur dhe e përshtatshme, intervistat me fëmijët do t'i kryejnë të njëjtat persona	Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Neni 23.2 (c) Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3 (d) Konventa e Lanzarotes: Neni 35.1 (d)	
<i>vazhd. 6. Intervistat mjekoligjore</i>	Intervistat e viktimave të dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore ose dhunës në marrëdhënie të ngushtë kryhen nga	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 23.2 (d)	

Shënimet fundore

	persona të së njëjtës gjini me viktimën		
	Numri i intervistave kufizohet sa të jetë e mundur. Ato kryhen vetëm kur është rreptësisht e nevojshme dhe në funksion të hetimeve dhe të procedimit penal	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 20(b)</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3 (e)</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 35.1 (e)</p>	
<i>vazhd. 6. Intervistat mjekoligjore</i>	Të gjitha intervistat me një fëmijë viktimë ose sipas rastit fëmijë dëshmitar, mund të regjistrohen në mënyrë audiovizuale. Këto regjistrime mund të përdoren si prova në proceset gjyqësore penale	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Neni 24.1 (a)</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.4 4</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 35.2</p>	Shih edhe standardin 1.2.

Shënimet fundore

	Mundësia për të urdhëruar që fëmija viktimë të dëgjohej duke përdorur teknologjitë e përshtatshme të komunikimit	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Deklamimi 58, Neni 23.3 (a) (b)</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.5 (b)</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 36.2 b</p>	Shih edhe standardin 1.2.
	E drejta për të shmangur kontaktet mes viktimës dhe autorit të krimit	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Deklamimi 58, Neni 19 1.-2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 31.1</p>	Shih edhe standardin 4.
<i>vazhd. 7. Ekzaminimi mjekësor</i>	Trajnime & instrumente	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 61, 63, Neni 25</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30 A</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5.1, 5.2, 35.1 (c), 36.1</p>	Shih edhe standardin 9.

Shënimet fundore

	Aspekti shumëdisiplinor/bashkërendimi/bashkëpunimi	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 38, 62, Neni 26. 1 Konventa e Lanzarotes: Neni 10.1.	Shih edhe standardin 5.
7. Ekzaminimi mjekësor	Marrja në konsideratën e duhur e pikëpamjeve të fëmijës	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 1. 2; 10.1 dhe 10.2 Direktiva për abuzimin seksual: 19.3 Konventa e Lanzarotes: Neni 14.1	Shih edhe standardin 1.2.
	Dhënia e informacionit	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 1.1.; 3; 4; 6 Konventa e Lanzarotes: Neni 31.1, 31.6	Shih edhe standardin 1.2.
<i>vazhd. 7. Ekzaminimi mjekësor</i>	E drejta për përkthim me gojë dhe me shkrim	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 5.2-3; 7.1-7.8 Konventa e Lanzarotes: 31.6	Shih edhe standardin 1.2. Neni 31.6 i Konventës së Lanzarotes përmendet këtu për shkak se referon te informacioni që duhet dhënë në një gjuhë që fëmija mund ta kuptojë.

Shënimet fundore

	Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 38, Neni 8. 1-5, 9. 1.-3, 25. 4</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 31, Neni 18.1</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 14.1</p>	
	Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 9, 55, 56, Neni 22. 1, 22.4</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: 19.3</p>	Shih edhe standardin 5.
<i>vazhd. 7. Ekzaminimi mjekësor</i>	Përfshirja e profesionistëve të trajnuar në vlerësimin psikosocial, intervistën mjekoligjore dhe ekzaminimet fizike / Trajnime dhe instrumente	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 25.4</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 36</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5.1, 5.2</p>	Shih edhe standardin 9.

	HETIMI PENAL: Kontrollet mjekësore (mjekoligjore) janë shumë të kufizuara	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 20 (c) (d)	
8. Shërbimet terapeutike / Shëndeti Mendor	Marrja në konsideratën e duhur e pikëpamjeve të fëmijës	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 1. 2; 10.1 dhe 10.2 Direktiva për abuzimin seksual: 19.3 Konventa e Lanzarotes: Neni 14.1	Shih edhe standardin 1.2.
<i>vazhd. 8. Shërbimet terapeutike / Shëndeti Mendor</i>	Dhënia e informacionit	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 1.1.; 3; 4; 6 Konventa e Lanzarotes: Neni 31.1, 31.6	
	E drejta për përkthim me gojë dhe me shkrim	Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 5.2-3; 7.1-7.8 Konventa e Lanzarotes: 31.6	Shih edhe standardin 1.2. Neni 31.6 i Konventës së Lanzarotes përfshihet këtu për shkak se i referohet informacionit të dhënë në një gjuhë që fëmija mund të kuptojë.

Shënimet fundore

	Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 1.1, 8. 1-5, 9, 17, 25. 4</p> <p>Direktiva mbi abuzimin seksual: Deklamimi 31, Neni 18.2, 18.3, 19.1-19.5</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 11.1, Neni 14.1, 14.4</p>	Shih edhe nenin 38.1 b të Konventës Lanzarotes për aspektin shumëdisiplinor në bashkëpunimin ndërkombëtar
<i>vazhd. 8. Shërbimet terapeutike / Shëndeti Mendor</i>	Vlerësimi individual i rrethanave të çdo fëmije dhe i nevojave të anëtarëve joabuzues të familjes	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 9, 55, 56, 56, Neni 22.1, 22.4</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: 19.3</p>	Shih edhe standardin 5.
	Përfshirja e profesionistëve të trajnuar në vlerësimin psikosocial, në intervistën mjekoligjore dhe ekzaminimet fizike / Trajnime dhe instrumente	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 66, Neni 25.4</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30, 36</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5.1, 5.2</p>	Shih edhe standardin 9.

Shënimet fundore

<p>9. Ngritja e kapaciteteve</p>	<p>Intervistat kryhen nga ose përmes profesionistëve të trajnuar për këtë qëllim</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimave: Neni 23.2 (b)</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.3 (c)</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 35.1 (c)</p>	<p>Shih edhe standardin 6.</p>
<p><i>vazhd. 9. Ngritja e kapaciteteve</i></p>	<p>Dhënia e ndihmës dhe mbështetjes</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 66, Neni 8. 1-5, 9. 1.-3, 25. 4</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5.1, 5.2</p>	<p>Shih edhe standardin 7 dhe 8.</p>
	<p>Përfshirja e profesionistëve të trajnuar në kryerjen e vlerësimeve psikosociale, të intervistave mjekoligjore dhe të ekzaminimeve mjekësore/Trajnime & instrumente</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 61, 62, 66 Neni 25</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30, 36 Neni 20.3 (c)</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5.1, 5.2, 35.1 (c), 36.1</p>	<p>Shih edhe standardin 6, 7 dhe 8.</p>

<p>10. Parandalimi: shkëmbimi i informacionit dhe ndërtimi i aftësive të jashtme</p>	<p>Masa të domosdoshme për mbrojtjen e privatësisë, identitetit dhe imazhit të fëmijës viktimë dhe për parandalimin përhapjes së çdo lloj informacioni që mund të shpjerë në identifikimin e tij</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 21. 1-2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Neni 20.6</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 31.1 (e)</p>	<p>Ky detyrim ligjor është thelbësor për të gjitha punët e shërbimit; megjithatë, instrumentet ligjore përqendrohen kryesisht te ky detyrim në kontekstin e proceseve gjyqësore.</p>
<p><i>vazhd. 10. Parandalimi: shkëmbimi i informacionit dhe ndërtimi i aftësive të jashtme</i></p>	<p>Trajnim dhe instrumente</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 61, 62, Neni 25, 26.1</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 30, 36, Neni 23.1, 23.3</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5.1, 5.2, 35.1 (c), 36.1, 38</p>	<p>Neni 26.1 i Direktivës për të Drejtat e Viktimave dhe neni 38 i Konventës së Lanzarotes përmenden këtu për shkak referojnë te shkëmbimi i praktikave më të mira në kontekstin e bashkëpunimit ndërkombëtar.</p>
	<p>Të dhëna dhe monitorim</p>	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 62, 64</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 44</p>	<p>Mund të jetë me interes të shihet edhe kapitulli X i Konventës së Lanzarotes, i cili përqendrohet te mekanizmat e monitorimit nga Këshilli i Evropës.</p>

Shënimet fundore

		Konventa e Lanzarotes: Neni 10.2 (b)	
	Rritje ndërgjegjësimi	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Deklamimi 62, Neni 26.2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 34, 45, neni 23.1- 23.3</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 5, 6 dhe 8</p>	
<i>vazhd. 10. Parandalimi: shkëmbimi i informacionit dhe ndërtimi i aftësive të jashtme</i>	Parandalimi	<p>Direktiva për të Drejtat e Viktimës: Neni 26.1, 26.2</p> <p>Direktiva për abuzimin seksual: Deklamimi 34, 37, 45, Neni 22, 23.1-3</p> <p>Konventa e Lanzarotes: Neni 4, 5.3, 7, 15, 16, 17, 38.</p>	<p>Shih edhe nenet 10.1, 10.3 të Konventës së Lanzarotes, të cilët përqendrohen në bashkëpunimin për të parandaluar abuzimin dhe shfrytëzimin seksual. Neni 26.1 i Direktivës për të Drejtat e Viktimës dhe neni 38 i Konventës së Lanzarotes përmenden këtu për shkak se referojnë te shkëmbimi i praktikave më të mira në kontekstin e bashkëpunimit ndërkombëtar.</p>

P R O M I S E



This project is co-funded by the European Union under the Rights, Equality and Citizenship Programme 2014-2020. This publication reflects the views only of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use, which may be made of the information contained therein.



This document has been translated in partnership with Translators Without Borders and their global team of volunteers. Find out more at www.translatorswithoutborders.org